✓ "Informimi i qytetarëve për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, rruga drejt integrimit të suksesshëm", mbështetur nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe zbatuar në Bashkinë Shkodër. Objekti i përgjithshëm ishtë informimi dhe rritja e njohurive të qytetarëve mbi proceset integruese të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të këtij projekti ishin: forume të hapura me qytetarë; zhvillimi i ditëve të hapura; zhvillimi i një konkursi mbi perceptimin e Bashkimit Europian përmes pikturës, esesë dhe poezisë në median sociale.

✓ "Studentët e drejtësisë në shërbim të qytetarëve për shërbimet sociale", me mbështetjen e World Vision Albania dhe bashkëfinancimin nga Bashkimi Europian. Objektivi kryesor është fuqizimi i studentëve të drejtësisë me njohuri mbi ligjin për ndihmën juridike parësore, si dhe shërbimet sociale që përfitojnë qytetarët nga bashkia; Përmirësimi i aksesit të grupeve në nevojë në lidhje me shërbimet sociale. Aktivitetet që po zbatohen janë zhvillimi i ditëve të hapura në bashkitë respektive duke përfshirë edhe njësitë administrative që kanë popullsinë më të madhe. Gjatë ditëve të hapura janë shpërndarë fletë informuese mbi shërbimet sociale dhe ndihmën juridike falas. Gjithashtu gjatë zhvillimit të ditëve të hapura kemi ofruar edhe ndihmën juridike parësore përmes këshillimit dhe orientimit si dhe plotësimit të formularëve të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.

✓ "Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit në Shqipëri nëpërmjet advokimit për ndërmarrjen e masave konkrete dhe ofrimin e modeleve të suksesshme" mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Objektivat specifikë të parashikuar janë: nxitja e qytetarëve për aplikimin e ndërmjetësimit; bashkëpunimi me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve dhe OSHC lokale për përmirësimin e ndërmjetësimit; advokim ndaj institucioneve përgjegjëse me

qëllim zbatimin e rekomanidmeve dhe masave të natyrës ligjore. Aktualisht, përmes mediave sociale kemi zhvilluar një fushatë ndërgjegjësuese online ku qytetarët janë informuar mbi shërbimin e ndërmjetësimit, kush e përfiton; tarifat e miratuara; çështjet mbi të cilat mund të përdoret ndërmjetësimi etj., si dhe është organizuar një forum online "Pyet ekspertin për ndërmjetësimin" ku përmes pyetjeve janë informuar mbi këtë shërbim.

- ✓ "Masat për parandalimin për trafikimin e qenieve njerëzore si dhe parandalimin e përhapjes së COVID-19 në strehëzat ku strehohen viktimat dhe viktimat potenciale të trafikimit" mbështetur nga GIZ, PaCT. Objektivi i përgjithshëm është garantimi i të drejtave të viktimave të trafikimit, si dhe parandalimin e përhapjes së COVID-19 brenda strehëzave në të cilat janë të strehuara kjo kategori përfituese; të koontribuojë për të forcuar mirëqenien dhe qëndrueshmërinë e viktimave (potenciale) duke fuqizuar autoritetet publike dhe organizatat e shoqërisë civile për të kryer fushata ndërgjegjësimi tek grupet e synuara. Përfituesit kryesorë janë viktimat e trafikimit që strehohen pranë strehëzave, si dhe viktimat potenciale për ta parandaluar si fenomen. Me qëllim ndërgjegjësimin e tyre, ekspertët e kontraktuar kanë hartuar një raport vlerësimi mbi nevojat dhe sfidat që hasin viktimat e trafikimit që strehohen në strehëz gjatë periudhës së pandemise.

## Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.1

| Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.1 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit Strategjik.1** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 0 | 0% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 1 | 20% |
| Të pazbatuara | 0 | 0% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 4 | 80% |
| Të paraportuara | 0 | 0% |
| **Totali** | **5** | **100%** |






***Rezulton se nga 5 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 1, 1 është pjesërisht e zbatuar/ në proces zbatimi nga institucionet përgjegjëse, 4 masa të tjera janë parashikuar në vitet në vijim.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 20% pjesërisht i zbatuar/ në proces zbatimi dhe 80% jashtë periudhë së raportimit (në vitet në vijim), nga institucionet përgjegjëse.

## Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.2

| Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.2 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektivit Strategjik.2** | **Numri I aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 10 | 77% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 1 | 7.7% |
| Të pazbatuara | 0 | 0% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 1 | 7.7% |
| Të paraportuara | 1 | 7.7% |
| **Totali** | **13** | **100%** |







***Rezulton se nga 13 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 2, 10 janë të zbatuara, 1 pjesërisht e zbatuar/ në proces zbatimi, 1 aktivitet është parashikuar në vitet në vijim, si dhe 1 aktivitet i pa raportuar nga institucionet përgjegjëse***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 77% të realizuara, 7.7% pjesërisht i zbatuar/ në proces zbatimi, 7.7% jashtë periudhë së raportimit (në vitet në vijim), si dhe 7.7% të pa raportuar nga institucionet përgjegjëse.

*Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2020.*

❖ Rezultati i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e Kuvendit janë politika dhe legjislacion më i përgjegjshëm në përputhje me nevojat e qytetarëve. Organizatat e shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në këtë pjesëmarrje, pasi ato shërbejnë si një urë lidhëse mes Kuvendit dhe qytetarëve. Pjesëmarrja e publikut është veçanërisht e rëndësishme kur flitet për grupet vulnerabël, zëri i të cilëve shpesh neglizhohet të dëgjohet nga vendimmarrësit.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit është një element i rëndësishëm i asaj që sot ka filluar të quhet “demokracia pjesëmarrëse”. Kjo formë demokracie nuk zëvendëson demokracinë përfaqësuese, por e plotëson atë dhe e bën funksionale. Në këtë kuptim, pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit krijon kushtet e nevojshme për qytetarët që të marrin pjesë aktive në jetën politike gjatë gjithë legjislaturës dhe jo vetëm në momentin kur i kërkohet të zgjedhin atë; i krijon mundësinë qytetarëve që të avokojnë për interesat e tyre të ligjshme dhe kështu të kontribuojnë për krijimin e një demokracie të qëndrueshme; detyron institucionin të jetë më transparent dhe afron deputetët më shumë me zgjedhësit; kontribuon në përmirësimin e legjislacionit dhe lehtëson implementimin e tij.

✓ Monitorimi i SELP kryhet nga Rrjeti Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut, që është ngritur nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e Kuvendit, dhe që ka në përbërjen e tij përfaqësues të institucioneve më të rëndësishme në nivel qendror dhe vendor, përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, nga organet e sistemit të drejtësisë si dhe përfaqësues nga fakultetet e drejtësisë. Organet e Rrjetit janë Komisioni Drejtues dhe Bordi Këshillimor.

Mbledhja e parë e Rrjetit u zhvillua në datë **10.10.2019,** ditë në të cilën është konstituuar edhe Komisioni Drejtues i Rrjetit. Në po atë mbledhje të zhvilluar në këtë datë, Komisioni Drejtues miratoi Vendimin për krijimin e Bordit Këshillimor, si dhe Vendimin për pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në Rrjetin Kombëtar për Edukimin Ligjor dhe në Komisionin Drejtues.

Në mbledhjen e datës 17.01.2020, Komisioni Drejtues miratoi Rregulloren e Rrjetit si dhe zgjodhi pesë anëtarët e Bordit Këshillimor, nga radhët e pedagogëve dhe ekspertëve në fushën e edukimit ligjor.

Në datë 10.7.2020 është zhvilluar takimi i parë i Bordit Këshillimor, në të cilin është diskutuar mbi identifikimin e masave/aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit SELP, për të cilat kërkohet ekspertiza e anëtarëve të Bordit.

Në takimin e Rrjetit të datës 20 nëntor 2020, u bë prezantimi i Planit të Veprimit SELP, të miratuar me VKM nr.878, datë 11.11.202 “Miratimin e planit të veprimit 2020–2023, në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019–2023”.
Në faqen zyrtare të Kuvendit, në rubrikën “Lajmet e fundit”, është publikuar njoftimi për zhvillimin e takimit të parë të Rrjetit si dhe në vazhdim njoftimet për konsituimin e Komisionit Drejtues dhe të zgjedhjes së anëtarëve të Bordit Këshillimor, si dhe për mbledhjet e zhvilluara nga Rrjeti dhe organet e Rrjetit.

✓ Në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit është bërë funksional linku i Strategjisë[20], në të cilin janë publikuar gjithë aktet e miratuara deri tani nga Kuvendi, Rrjeti dhe Komisioni Drejtues, konkretisht:

*1.Vendimi i Kuvendit për miratimin e SELP*
*2.VKM nr.878, datë 11.11.202 “Miratimin e planit të veprimit 2020–2023, në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019–2023”*
*3.Rregullorja e Rrjetit*

[20] https://www.parlament.al/Strukture?kategori=2006&strukture=2061

*4.Vendimet e Komisionit Drejtues*
*5. Procesverbalet e mbledhjeve të Rrjetit dhe të Komisionit Drejtues*

- ✓ Në vazhdim të detyrave të përcaktuara në Planin e Veprimit, është bërë përditësimi i të dhënave në linkun e krijuar.

Gjithashtu, për komunikimin me anëtarët e Rrjetit është krijuar dhe adresa zyrtare e e-mailit Rrjeti.Selp@parlament.al .
Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Strategji për konstituimin e Rrjetit Kombëtar dhe për funksionimin e tij, ka siguruar kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe financiare për funksionimin e Rrjetit.

Në takimin e Rrjetit të datës 20 nëntor 2020 u diskutuan dhe janë ftuar anëtarët e Rrjetit për të kontribuar në hartimin e Planit të Komunikimit të Rrjetit. Aktualisht projekti i Planit të Komunikimit, procesi i hartimit dhe konsultimit me anëtarët e Rrjetit u përfundua brenda muajit dhjetor 2020.

- ❖ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hedhur në faqen e saj aktivitet për Edukimin Ligjor të Publikut që ka zhvilluar në kuadër të ligjit të Pyjeve, Strategjisë për menaxhimin e mbetjeve dhe VKM-të në fushën e turizmit për përdorimin e plazheve. Takime me grupin e riciklluesve dhe grupimin e bisneseve që kanë si bisnes marketet.

- ❖ Ministria e Drejtësisë, ka publikuar në faqen zyrtare të saj të gjitha aktet nënligjore dhe dokumentat e hartuara në zbatim të drejtësisë penale për të mitur, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me Bashkitë në kuadër të ofrimit të një drejtësie miqësore për të miturit.

- ✓ Ministria e Drejtësisë udhëheq dhe ndjek hartimin dhe implementimin e dokumenteve strategjike në fushën e antikorrupsionit, bashkërendon punën për hartimin e tyre dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nën-ligjore për paradalimin dhe luftën kundër korrupsionit si dhe luan një rol të rëndësishëm në edukimin ligjor kundër korrupsionit.
- ✓ Në përputhje me nevojën për Edukim Ligjor të Publikut, Ministria e Drejtësisë ka përfunduar hartimin e një strategjie komunikimi dhe vizibiliteti për vitin 2020 në kornizën e fushës së përgjegjësive antikorrupsion, objektivat e të cilave rrjedhin nga Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023.
- ✓ Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Strategjisë së Komunikimit dhe Vizibilitetit synon ngritjen e profesionalizmit dhe krijimin e procedurave të qarta për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve të komunikimit.
- ✓ Ky dokument ka si synim kryesor ndërgjegjësimin mbi korrupsionin dhe nxitjen e bashkëpunimit ndaj këtij fenomeni me qëllim krijimin e institucioneve shqiptare transparente dhe me integritet të lartë si dhe forcimin e besimit të qytetarëve.
- ✓ Në përmbushje dhe zbatim të këtij dokumenti, MD/KKK incion edhe aktivitete, takime dhe organizime të ndryshme me qëllim forcimin e njohurive të të qytetarëve dhe publikut të gjerë kundër korrupsionit, rritjen e ndërgjegjëzimit për përdorimin e mekanizmave antikorrupsion dhe evidentimin e nismave dhe veprimtarive në luftën kundër korrupsionit.

- ❖ Duke qenë tërësisht të vetëdijshëm se rritja e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj përveçse një detyrimi ligjor (neni 8 i ligjit 111/2017), është një nga komponentët me thelbësorë të funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dhe forcimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi, DNJF i ka kushtuar një vemëndje të shtuar informimit mbi sistemin e ndihmës juridike falas duke u ndalur në hartimin dhe publikimin e materialeve të

vizibilititetit si dhe publikimit të postimeve/videove ndërgjegjësuese në rrjetet sociale të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

- ✓ Zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të forcimit të sistemit të ndihmës juridike parësore.

Aktivitet Ndërgjegjësues "Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin" ku përfaqësuesit e ndihmës juridike falas patën mundësinë të bashkëbisedonin me të miturit e kësaj qendre duke i shpjeguar në mënyrë të thjeshtëzuar se si ata apo prindërit e tyre mund të përfitonin nga shërbimet ligjore falas.

Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve është një nga parimet më thelemore të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Formë e mbrojtjes së këtij interesi është edhe aksesi në drejtësi për të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin duke garantuar një shërbim ligjor falas dhe cilësor. Nga ky këndvështrim, ishte e nevojshme të bëheshin ndryshime ligjore në legjislacionin e procedurës penale dhe gjithashtu në ligjin "Për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti".

Me qëllim zgjidhjen e problematikave dhe përfitimin e shërbimit nga të mitur, përfaqësuesit e DNJF shkëmbyen kontaktet me Punonjësit Socialë të Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve të cilët ishin mëse të gatshëm për bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas në trajtimin e këtyre rasteve.

- ✓ Tryezë e Përbashkët në kuadër të promovimit dhe nxitjes së sistemit të ndihmës juridike falas, ku qëllimi i kësaj tryeze konsistonte në rëndësinë dhe efikasitetin që duhet të ketë Sistemi i Ndihmës Juridike Parësore dhe fokusin për të rritur urat e bashkëpunimit ndërinstitucional në mënyrë të tillë që çdo qytetari t'i garantohet akses në Drejteësi.

Intervista televizive me qëllim përcjelljen e njohurive mbi sistemin e ndihmës juridike falas tek qytetarët, gjatë të cilit është diskutuar mbi ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas gjatë periudhës së pandemisë, sistemin e ndihmës juridike falas, ofruesit e këtij shërbimi dhe kategoritë përfituese. Këto intervista kanë vijuar të zhvillohen me qëllim përmbushjen e objektivit të DNJF lidhur me promovimin e sistemit të ndihmës juridike falas dhe edukimin ligjor të publikut.

- ✓ Publikime dhe produkte të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të vizibilitetit.

Publikimi i manualit të thjeshtëzuar mbi kriteret dhe procedurën "Si të përfitojmë ndihmë juridike falas". Promovimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore përmes vendosjes së posterave pranë institucioneve kryesore në vend.

Gjithashtu, janë hartuar dhe vendosur në dispozicion të qytetarëve fletëpalosje të dedikuara për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat DNJF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

- ✓ Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare në kuadër të transparencës dhe informimit të qytetarëve, përmes publikimit të raportimeve të ndryshme,si dhe manualeve në ndihmë të qytetarëve për përfitimin e shërbimit..

Është finalizuar faqja zyrtare e DNJF dhe është vendosur në dispozicion të publikut. Aktualisht DNJF është duke e përditësuar faqen në mënyrë aktive përmes publikimit të raportimeve të ndryshme në kuadër të transparencës si dhe manualeve në ndihmë të qytetarëve për përfitimin e shërbimit.

- ✓ Promovimi i sistemit të shërbimit të ndihmës juridike falas përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram.

Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët dhe duke marrë parasysh faktin se ky shërbim është relativisht i ri dhe i panjohur për të shumtën e qytetarëve, DNJF është duke punuar në mënyrë të vazhdueshme për promovimin e këtij sistemi përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram të cilat janë mjaft të përdorshme nga qytetarët. Është vijuar me postime të vazhdueshme informative mbi procedurat që duhen ndjekur për përfitimin e këtij shërbimi si dhe janë mbajtur komunikime të vazhdueshme me qytetarët të cilët na janë drejtuar për të kërkuar informacion.

- ✓ Përfshirja e sistemit të ndihmës juridike falas si E-shërbim në platformën E-albania.

Si një mjet mjaft i mirë në kuadër të përmbushjes së këtij qëllimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, i ka propozuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, përfshirjen e ndihmës juridike falas si E-shërbim në Platformën E-ALBANIA. Kjo platformë, sidomos periudhën aktuale për shkak të pandemisë Covid-19, ka një përdorim mjaft të gjerë ndaj edhe përfshirja e E-shërbimit "Ndihmë juridike falas" do të ketë një impakt në rritjen e nivelit të informacionit të qytetarëve mbi këtë sistem. Të gjithë shtetasit tashmë mund të përfitojnë shërbimet e këshillimit ligjor direkt nga e-albania bashkë me të gjitha shërbimet e tjera online .

- ✓ Platforma e katërt Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mori pjesë në Platformën e katërt Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri, organizuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal Ekipi i Veprimit për Integrimin e Romëve, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në këtë takim, u prezantua "Raporti mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri, për vitin 2019" dhe u diskutuan politikat kombëtare dhe prioritetet për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në fushat kryesore, pjesë e së cilave ishin edhe masat dhe indikatorët të cilat janë nën fushën e përgjegjësisë së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

- ✓ Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, si një nga aktorët mbështetës për projektin "Ligji është jetë – Mbrojeni jetën tuaj!" mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Shoqata "Unë, Gruaja" për Vullnetarët e Ligjit me temë: "Rritja e kapaciteteve për grupet mbështetëse në lidhje me informacionin ligjor për publikun dhe qasjen e tij në drejtësi".

Ky trajnim u organizua në kuadër të projektit: "Ligji është jetë- Mbrojeni jetën tuaj!" i cili po zbatohet nga Shoqata "Unë, Gruaja", me mbështetjen UNDP Albania dhe fonde të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

- ✓ Projekti "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministria e Drejtësisë dhe financim të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).

Në përmbushje të misionit madhor të Ministrisë së Drejtësisë, garantimit të aksesit në drejtësi për çdo qytetar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e qeverisjes e nivelit qëndror, lokal dhe sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka vijuar me komunikimet me qëllim promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit tek qytetarët në lidhje me sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti duke kërkuar nga institucionet shtetërore afishimin e posterave "Ke nevojë për ndihmë juridike". Këto postera janë konceptuar nga Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Euralius V, ku platforma jurstionline.al dhe numri i gjelbër 0801010 janë financuar nga "Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë" dhe kanë për qëllim kryesor ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe orientimin e tyre drejt sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, si element thelbësor i aksesit në drejtësi.

- ✓ Nënshkrimi i 25 marrëveshjeve "Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve" nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" me Gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

Në përmbushje të misionit madhor të Ministrisë së Drejtësisë, "Sigurimit të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive, për të gjithë kategoritë përfituese", Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka nënshkruar 25 marrëveshje me Gjykatat e Republikës së Shqipërisë me objekt :"Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017,

"Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti". Duke vlerësuar maksimalisht rolin që kanë Gjykatat në sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, këto marrëveshje janë një vlerë e shtuar në përmbushje të misionit të DNJF.

<u>Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit</u>

- ✓ Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Fierit.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas po vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si edhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas.

Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF ishte në qytetin e Fierit ku organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u afishuan postera të ndihmës juridike në institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; Prokuroria; Bashkia; Shtëpia e të moshuarve; ADISA... etj si dhe u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.

- ✓ Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Lezhës.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas po vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si edhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas. Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF ishte në qytetin e Lezhës ku organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u afishuan postera të ndihmës juridike në institucione, si dhe u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.

- ✓ Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Tiranës.

Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.

- ✓ Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Durrësit.

Gjatë muajit dhjetor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.

- ✓ Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Shkodrës.

Gjatë muajit dhjetor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.

- ✓ Takim informues me qytetarë të komunitetit Romë dhe Egjiptian në Tiranë, mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Ekipi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas organizoi një takim me qytetarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian në zonën e Shkozës, Tiranë, bashkë me përfaqësuesit e Klinikës Ligjore Wisdom, me të cilët është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Pjesëmarrësit, si një ndër kategoritë përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, u informuan mbi të drejtat që ligji për ndihmën juridike u garanton dhe mënyrën e përfitimit të ndihmës juridike falas. U zhvillua një bashkëbisedim mbi problematikat ligjore të qytetarëve, të cilat do të adresohen për t'u trajtuar në Klinikën e Ligjit Wisdom dhe Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë.

Në total për vitin 2020, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur 9 (nëntë) Marrëveshje Bashkëpunimi, të dhëna specifike mbi të cilat janë parashtruar si vijon:

- Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin e Drejtësisë;
- Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Bedër;

- Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Wisdom;
- Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Europian të Tiranës;
- Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës;
- Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Ismail Qemali Vlorë;
- Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Qiriazi;
- Marreveshje Bashkëpunimi me Universitetin Mesdhetar;
- Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin OSFA (Klinika e Ligjit Shkodër).
- Takim me organizatat jofitimprurëse të autorizuara që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti.

❖ Ka disa vite tashmë që Qeveria Shqiptare nga 25 nëntori- 10 dhjetor të çdo viti i bashkohet fushatës ndërkombëtare të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj gruas.
Në të gjithë botën kjo fushatë përdoret si një strategji e organizuar si nga individë ashtu dhe grupe me qëllim që t'iu jepet fund të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, apo për të propozuar rrugë të reja qoftë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për të luftuar këtë dukuri me pasoja mjaft negative për të gjithë shoqërinë. Më datën 25 nëntor u lancua hapja e fushatës së 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, nën sloganin "Dëgjo Beso Mbështet", "Botaportokalli", "OrangetheWorld". Lidhur me masat e parashikuara në Strategjinë e Edukimit Ligjor të Publikut MSHMS në kuadër të punës që bën me nëpunësit gjinorë dhe koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje, informon dhe trajnon ata lidhur me kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar, i bën pjesë të konsultimeve gjatë rishikimit të akteve ligjore dhe nënligjore, dhe i trajnon me çdo ndryshim ligjor në fushën e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje.

✓ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, dhe me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve te Bashkuara "T'i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri", me fonde të Qeverisë Suedeze, ka zhvilluar gjatë këtij viti një cikël trajnimesh për të njohur koordinatorët me ndryshimet e Ligjit Nr.9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar me Ligjin Nr. 47/2018 si dhe kuadrin nënligjor.

✓ Për ndryshimet më të fundit në këtë ligj, i cili u ndryshua me Ligjin Nr. 125/2020 po në bashkëpunim me shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe UNDP, në kuadër edhe të 16 ditëve të aktivizmit ka zhvilluar nëpërmjet platformës online trajnime me koordinatorët vendorë në datat dt.9/10/14/15 dhjetor me temë: "Dhuna në familje dhe roli i autoriteteve përgjegjëse".

✓ Një cikël i plotë trajnimesh është zhvilluar gjithashtu me të gjithë koordinatorët vendorë lidhur me Procedurat Standarde të Veprimit për punonjëset dhe punonjësit e shëndetësisë dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror,: a)"Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 101, datë 21.02.2020 "Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR)"; b) Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 100, datë 21.02.2020 "Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/ punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR)" dhe c) Urdhrit të Ministrit së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 102, datë 21.02.2020 "Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, për

zvogëlimin e rrezikut të përjetimit të dhunës në familje e të dhunës me bazë gjinore, në situata të emergjencave civile". PSV dhe trajnimet janë mbështetur nga UNFPA.

✓ Gjithashtu Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) ka udhëzuar Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), mbi masat e reja të mbrojtjes që duhet të aplikojnë vetë punonjësit, në periudhën e COVID -19, gjatë punës në terren me fëmijët dhe familjet. Agjencia, gjatë kësaj kohe ka mbajtur në monitorim situatën dhe ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në të gjithë vendin, duke ofruar mbështetje teknike për menaxhimin e rasteve, duke koordinuar ndërhyrjet institucionale për marrjen në mbrojtje të çdo rasti të fëmijëve të dhunuar, të abuzuar apo neglizhuar, për të siguruar që fëmijët të marrin shërbimet e nevojshme dhe trajtim psikologjik të specializuar.

❖ **European Centre**

Ofrimi i ndihmes juridike parësorë dhe dytësore nga Klinika e Ligjit–Vlorë; Sesione informuese mbi shërbimet e Klinikës së Ligjit dhe ofrimit të ndihmës juridike falas; Shpërndarja e një fletëpalosje informuese.

❖ **Qendra Altri**

Fletë informuese mbi ndihmën ekonomike, respektimin e të drejtave të përsonave me aftësi të kufizuar dhe fletëinformuese për ndihmën juridike parësore; Ofrimi i ndihmës juridike parësore. Krijimi i bashkëpunimit me MD dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Parësore.

## Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.2

| Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.2 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit Strategjik.2** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 5 | 71.4% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 2 | 28.6% |
| Të pazbatuara | 0 | 0% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 0 | 0% |
| Të paraportuara | 0 | 0% |
| **Totali** | **7** | **100%** |






***Rezulton se nga 7 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 1, 5 janë të zbatuara, si dhe 2 janë pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi nga institucionet përgjegjëse.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 71% të realizuara, si dhe 29% pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi nga institucionet përgjegjëse.

## Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.3

| Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.3 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektivit Strategjik.3** | **Numri i aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 3 | 30% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 4 | 40% |
| Të pazbatuara | 0 | 0% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 2 | 20% |
| Të paraportuara | 1 | 10% |
| **Totali** | **10** | **100%** |







***Rezulton se nga 10 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 3, 3 janë të zbatuara, 4 pjesërisht e zbatuar/ në proces zbatimi, 2 aktivitete janë parashikuar në vitet në vijim, si dhe 1 aktivitet i pa raportuar nga institucionet përgjegjëse***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 30% të realizuara, 40% pjesërisht i zbatuar/ në proces zbatimi, 20% jashtë periudhë së raportimit (në vitet në vijim), si dhe 10% të pa raportuar nga institucionet përgjegjëse.

*Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2020.*

❖ Shkolla e Magjistraturës ndikon në edukimin ligjor të publikut nëpërmjet trajnimit të profesioneve të caktuara, të cilat, gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre funksionale, ndikojnë në edukimin e publikut mbi ligjin.

✓ Shkolla e Magjistraturës ka plotësuar kurrikulat për Programin e Formimit Fillestar për kancelarët e gjykatave dhe është duke përfunduar Programin e Formimit Fillestar për kancelarët e prokurorive. Ky program do të jetë i përbashkët dhe do të reflektojë në kurrikulat e tij dallimet

ndërmjet kancelarit të gjykatës dhe atij të prokurorisë. Programi për kancelarët e gjykatave është realizuar me mbështetjen e USAID, ndërsa Programi për kancelarët e prokurorive është përshtatur me mbështetjen e EURALIUS. Ky program parashikon modul të veçantë për marrëdhëniet me publikun, për komunikimin dhe etikën.

✓ Ka organizuar disa aktivitete në formën e trajnimit të trajnerëve me grupin e punës së hartimit të kurrikulave të kancelarëve të gjykatave dhe prokurorive.

✓ Shkolla e Magjistraturës ka realizuar trajnime për kancelarët e gjykatave, kancelarët e prokurorive, drejtuesit e prokurorive dhe trajnime të kombinuara me qëllim interpretimin dhe zbatimin e parimeve që lidhen me marrëdhëniet me publikun, komunikimin me publikun dhe median, rolin e tyre në përcjelljen e informacionit në mënyrë të kuptueshme dhe etike për përdoruesit e gjykatës apo prokurorisë. Të gjithë këto elementë ndikojnë në dijen, njohuritë dhe edukimin ligjor të publikut mbi rolin e gjykatës/prokurorisë dhe procedurat e ndjekura nga ana e tyre.

✓ Ka realizur disa aktivitete trajnimi për çështje që ndikojnë në edukimin ligjor të publikut, si "Barazia gjinore dhe dhuna seksuale", "E drejta për jetë private të qetë dhe kufizimet e saj" dhe "Roli i gjykatave në interpretimin e ligjit "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

✓ Shkolla e Magjistraturës i kushton rëndësi rolit të magjistratit të shtypit, lirisë së shprehjes dhe marrëdhënieve me median në raport me informacionin që ka të drejtë dhe detyrim të japë gjykata ose prokuroria. Në zbatim të kësaj dhe të analizës së përgjithshme të nevojave që zhvillon çdo fillim viti akademik, Shkolla do të organizojë dy trajnime me fokus këto çështje.
Gjithashtu, Shkolla do të zbatojë përgjatë vitit akademik 2020-2021 edhe projektin "JUFREX" të Këshillit të Europës, i cili ka si tematikë Lirinë e shprehjes dhe median dhe raportin me gjyqësorin dhe prokurorinë. Ky projekt, parashikon zgjerimin e rrethit të trajnerëve me gjyqtarë dhe prokurorë të specializuar në këtë tematikë për të realizuar një njohje dhe zbatim të thelluar të parimeve që lidhen me këtë të drejtë dhe kufizimet e saj.

✓ Lidhur me Rishikimin e Programit të Formimit Vazhdues për të pasqyruar nevojat e reja për trajnim është realizuar, konkretisht është rikonsideruar vendosja e trajnimeve të grupit të punës për kurrikulat e kancelarëve të prokurorisë dhe ato janë bërë pjesë e kalendarit përgjatë vitit akademik.

## Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.3

| Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.3 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit Strategjik.3** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 0 | 0% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 4 | 100% |
| Të pazbatuara | 0 | 0% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 0 | 0% |
| Të paraportuara | 0 | 0% |
| **Totali** | **4** | **100%** |







***Rezulton se nga 4 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 3, 4 janë pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi nga institucionet përgjegjëse.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 100% pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi nga institucionet përgjegjëse.

## Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.4

| Statusi aktual i aktiviteteve të Objektivit Strategjik.4 | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektivit Strategjik.4** | **Numri i aktiviteteve** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 18 | 37.5% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 8 | 17% |
| Të pazbatuara | 1 | 2% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 7 | 14.5% |
| Të paraportuara | 14 | 29% |
| **Totali** | **48** | **100%** |







***Rezulton se nga 48 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 4, 18 janë të zbatuara, 8 pjesërisht e zbatuar/ në proces zbatimi, 7 aktivitete janë parashikuar në vitet në vijim, 1 aktivitet i pazbatuar, si dhe 14 aktivitete të pa raportuara nga institucionet përgjegjëse***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 37.5% të realizuara, 17% pjesërisht i zbatuar/ në proces zbatimi, 14.5% jashtë periudhë së raportimit (në vitet në vijim), 2% të pa zbatuara, si dhe 29% të pa raportuar nga institucionet përgjegjëse.

*Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2020.*

❖ Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve është një nga parimet më thelemore të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Formë e mbrojtjes së këtij interesi është edhe aksesi në drejtësi për të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin duke garantuar një shërbim ligjor falas dhe cilësor. Nga ky këndvështrim, ishte e nevojshme të bëheshin ndryshime ligjore në legjislacionin e procedurës penale dhe gjithashtu në ligjin "Për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti".

Ligji 111/2017, "Për Ndihmën Juridike të garantuar nga Shteti", në referim të nenit 11 të tij, tashmë i ka cilësuar të miturit si subjekte të posaçëm të cilët, pavarësisht nga të ardhurat e tyre janë përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.Konkretisht, fëmijët që jetojnë në institucione të kujdesit shoqëror; fëmijët në kujdestari, të cilët kërkojnë të fillojnë një proces pa pëlqimin e përfaqësuesit të tyre ligjor ose kundër përfaqësuesit të tyre ligjor; viktimat mitur dhe të miturit në kundërshtim me ligjin, në çdo fazë të procedurës penale (për të cilën nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme), mund të përfitojnë që nga këshillimi ligjor (ndihma juridike parësore) deri në përfaqësimin e çështjeve në gjykatë (ndihmë juridike sekondare).

✓ Pjesë e këtyre aktiviteteve ishte dhe Aktivtiteti “Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin” i cili u zhvillua me qëllim ndërgjegjësimin e të miturve pranë Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve.

✓ Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, si një nga aktorët mbështetës për projektin “Ligji është jetë – Mbrojeni jetën tuaj!” mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Shoqata “Unë, Gruaja” për Vullnetarët e Ligjit, me temë: “Rritja e kapaciteteve për grupet mbështetëse në lidhje me informacionin ligjor për publikun dhe qasjen e tij në drejtësi”.

✓ Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas po vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si edhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas. Pjesëmarrësit, si një ndër kategoritë përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, u informuan mbi të drejtat që ligji për ndihmën juridike u garanton dhe mënyrën e përfitimit të ndihmës juridike falas.

✓ Gjithashtu, duke ritheksuar edhe njëherë mbrojtjen e interesave më të lartë të fëmijëve, është detyrim ligjor që juristët/avokatët që ofrojnë shërbimin e ndihmës jurike falas, të jenë të specializuar në sistemin e Drejtësisë për të mitur përmes ndjekjes së trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme të organizuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas/Departamenti i Administratës Publike/ Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

✓ DNJF në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 8 shkronja “d” dhe “e” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ka vijuar me hartimin dhe publikimin e një manuali të thjeshtëzuar mbi kriteret dhe procedurën e përfitimit nga shërbimet e ndihmës juridike falas.

✓ Është finalizuar faqja zyrtare e DNJF dhe është vendosur në dispozicion të publikut. Aktualisht DNJF është duke e përditësuar faqen në mënyrë aktive përmes publikimit të raportimeve të ndryshme në kuadër të transparencës si dhe manualeve në ndihmë të qytetarëve për përfitimin e shërbimit.

✓ Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i ka propozuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, përfshirjen e ndihmës juridike falas si E-shërbim në Platformën E-ALBANIA. Kjo platformë, sidomos periudhën aktuale për shkak të pandemisë Covid-19, ka një përdorim mjaft të gjerë ndaj edhe përfshirja e E-shërbimit "Ndihmë juridike falas" do të ketë një impakt në rritjen e nivelit të informacionit të qytetarëve mbi këtë sistem. Të gjithë shtetasit tashmë mund të përfitojnë shërbimet e këshillimit ligjor direkt nga e-albania bashkë me të gjitha shërbimet e tjera online[21].

✓ Duke marrë në konsideratë faktin se kemi bashkëpunim me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë në të cilat janë të angazhuar studentë (Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, ligji nr.111/2017, i parashikon si ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore), në këtë kuadër, janë zhvilluar disa aktivitete qe synojnë ofrimin e shërbimit ligjor ndaj qytetarëve duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në edukimin ligjor të tyre. Theksojmë së një formë e ofrimit të shërbimit parësor të ndihmës juridike është: "dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor".

Në këtë mënyrë, duke ofruar shërbim ligjor falas është ofruar njëkohësisht edhe edukim ligjor / ndërgjegjësim për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve kundrejt sistemit ligjor të Republikës së Shqipërisë.

❖ Kuvendi i Shqipërisë në vazhdimësi kryen informimin e qytetarëve për iniciativat e reja ligjore dhe ndryshimet e ligjeve, si dhe në kuadër të transparencës së veprimtarisë parlamentare kryhet transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave parlamentare, mbledhjeve të komisioneve dhe cdo aktiviteti tjetër parlamentar.

✓ Duke vlerësuar edhe situatën e shkaktuar nga pandemia COVID - 19, Kuvendi zgjeroi metodat e komunikimit me publikun përmes rrjeteve sociale, faqes së FB të Kuvendit, transmetimit livestream dhe botimeve informative periodike. Në kuadër të funksionit ligjvënës që ushtron Kuvendi i Shqipërisë me qëllim respektimin e parimit të transparencës dhe për një Kuvend të hapur e sa më pranë qytetarit, në faqen zyrtare të Kuvendit është aktivizuar platforma "*Konsultimi i Projektligjeve*"[22] që do të ofrojë mundësinë e konsultimit online të të gjitha projektligjeve që komisionet parlamentare do të publikojnë. Konsultimi online i projektligjeve dhe dokumenteve të tjera parlamentare do t'i japë mundësi publikut, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit që të njihen dhe të adresojnë komente apo sugjerime konkrete që do t'u shërbejnë komisioneve parlamentare në procesin legjislativ të shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve, për përmirësimin e tyre.

<u>*Projekti për Mbështetjen e Kuvendit dhe Edukimit Qytetar (PACEP).*</u>

Kuvendi në bashkëpunim me Shërbimet Parlamentare Zvicerane dhe me mbështetjen e NDI, në kuadër te projektit PACEP, ka hartuar dy skenarë për njohjen e qytetarëve me veprimtarinë parlamentare.

✓ Skenari i parë është një tur i përgjithshëm i godinës së Kryesisë së Kuvendit dhe godinës së Sallës së Seancës Plenare. Audienca që ky tur synon janë të gjithë qytetarët, shqiptarë e të huaj

[21] https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=787&service_type=N

[22] http://konsultimi.parlament.al/?id=ad7aec52-7d66-468b-bd57-08d87b30b34d

(skenari është hartuar dhe në gjuhën angleze), që janë të interesuar të marrin njohuri të përgjithshme mbi legjislativin dhe jetën politike shqiptare.

- ✓ Skenari i dytë është një tur legjislativ, i cili synon studentë të drejtësisë, shkencave politike, diplomacisë apo fusha të ngjashme. Ndiqet i njëjti rrugëtim i turit të përgjithshëm por fokusi janë procedurat parlamentare dhe procesi ligjbërës

Turi Virtual është një tjetër aktivitet i modeluar sipas shembullit të parlamentit zviceran. Turi prezanton ambientet relevante të dy godinave të Kuvendit dhe jep informacion mbi pikat me interes. Turi synon të gjithë qytetarët, shqiptarë e të huaj që kanë interes të njohin Kuvendin.

*Praktika Parlamentare*

Kuvendi ka angazhuar këtë vit, nëpërmjet NDI brezin e tretë të praktikantëve të deputetëve dhe brezin e dytë të praktikantëve të administratës. Procesi përzgjedhës është tepër rigoroz dhe përzgjedhës, kjo ka rezultuar në angazhimin e një numri të rinjsh tepër të aftë dhe entuziast për të marrë pjesë në proceset parlamentare.
Këta të rinj, përveç se rriten profesionalisht dhe mësojnë në parlament, janë një ndihmë shtesë për deputetët dhe administratën. Për më tepër ata janë ambasadorë të Kuvendit në Shqipëri, transmetojnë në shoqëri një imazh tepër profesional të parlamentit.
COVID-19: Praktikantët janë angazhuar me përgatitjen e materialeve për faqen Facebook, duke përgatitur materiale edukuese dhe ndërgjegjësuese për qytetarët.

*Akademia e të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve*

Akademia e të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve është një aktivitet i përvitshëm, që prej vitit 2012, i organizuar nga Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut (GSHDNJ), në bashkëpunim të ngushtë dhe me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.
Akademia mundëson njohuri bazë mbi të drejtat në shoqërinë demokratike, çfarë duhet të dinë dhe si duhet të veprojnë të rinjtë për të qenë të vlefshëm në aktivizimin e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut dhe për t’iu dhënë zgjidhje këtyre problemeve.

Për shkak të kufizimeve si rrjedhojë e COVID-19, programi i Akademisë 2020 u zhvillua përmes një kombinimi të leksioneve online dhe atyre në terren. Aktiviteti i Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së pandemisë, roli i Medias në garantimin e transparencës së institucioneve nën masat kufizuese, reforma zgjedhore dhe edukimi i votuesve në prag të zgjedhjeve të përgjithshme në 2021, pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje, angazhimi i shoqërisë civile në zhvillimet demokratike në vend gjatë COVID 19, barazia gjinore dhe të drejtat e minoriteve ishin disa nga temat qendrore të këtij viti.

*Veprimtari në kuadër të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”*

Grupit i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” (GDMF) është krijuar pranë Kuvendit, me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, marrjen e nismave ligjore dhe hartimin e politikave dhe programeve për të drejtat e fëmijëve, si dhe forcimin e kontrollit parlamentar ndaj institucioneve shtetërore dhe institucioneve të pavarura për jetësimin e këtyre të drejtave.

*Veprimtaritë me të rinjtë dhe parlamentin rinor*

Parlamenti Rinor të është një strukturë e ideuar si një mekanizëm i domosdoshëm pjesëmarrjeje dhe mobilizimi për rininë. Parlamenti Rinor është rrjeti më i madh i nxënësve të shkollave të

mesme publike, të moshës 14-19 vjeç, të cilët vijnë së bashku për të përmirësuar pjesëmarrjen e tyre në debatet publike dhe proceset demokratike për të drejtat dhe përgjegjësitë.

Parlamenti Rinor ka zhvilluar disa aktivitete me Kuvendin, me qëllim ndërtimin e dialogut dhe bashkëpunimit midis ligjvënësve të Kuvendit të Shqipërisë dhe të rinjve në Shqipëri.

*Veprimtari në kuadër të Aleancës së Grave*

Aleanca e Grave Deputete në Kuvendin e Shqipërisë ka zhvilluar aktivitete të ndryshme si seanca dëgjimore dhe aktivitete ndërgjegjësuese duke luajtur një rol aktiv në përmirësimin e ligjeve me ndjeshmëri gjinore të cilat miratohen në Kuvend për t'i përshtatur ato me standardet më të mira ndërkombëtare.

✓ Një pjesë e konsiderueshme e veprimtarive të AGD-së janë zhvilluar dhe në bashkëpunim me Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas si dhe me komisione apo nënkomisione të tjera parlamentare, duke marrë pjesë në diskutimin e projektligjeve me ndjeshmëri gjinore në komisionet e përhershme parlamentare apo duke organizuar në bashkëpunim me këto komisione seanca dëgjimore publike në lidhje me çështje të ndryshme.

✓ Aleanca e Grave Deputete në bashkëpunim me Nënkomisionin Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe Nënkomisionin për Çështjet Vendore, organizuan një seancë dëgjimore me përfaqësues nga institucionet shtetërore, shoqëria civile, shoqatat vendore, lidhur me funksionimin e Mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor.

✓ Aleanca organizoi një seancë dëgjimore me institucionet përgjegjëse me temë: "Dhuna në familje" gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Gjatë seancës dëgjimore u prezantuan masat e marra nga qeveria për parandalimin e rasteve të dhunës në familje gjatë periudhës së kufizimeve të vendosura për shkak të pandemisë. Gjatë këtij sesioni deputetet ngritën pyetje dhe diskutuan për masat e marra nga institucionet, bashkëpunimin mes tyre, rolin e koordinatorit vendor etj.

✓ Në vijim, u zhvillua një seancë dëgjimore e përbashkët me Nënkomisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Nënkomisionin Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave, ku u diskutua së bashku me UN Women Shqipëri për parandalimin e dhunës me bazë gjinore në zgjedhje.

*Veprimtari në kuadër të legjislacionit me ndjeshmëri gjinore*

Kuvendi i Shqipërisë miratoi Program- Veprimin "Për një Kuvend të ndjeshëm gjinor". Programi i Veprimit "Për një Kuvend të Ndjeshëm Gjinor", ka parashikuar 6 prioritete, të cilat janë zbërthyer në 18 objektiva për realizimin e të cilave janë parashikuar një numër i madh aktivitetesh që janë planifikuar të zhvillohen gjatë periudhës 2020-2021, si dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e këtij Programi, monitorimi e kontrolli i progresit të kryer dhe afatet e realizimit.

*Veprimtari ndërgjegjësuese*

Aleanca e Grave Deputete, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë aktiviteteve me karakter sensibilizues në kuadër të javës së parandalimit të kancerit në qafën e mitrës dhe Ditës Botërore Kundër Kancerit.

❖ Bazuar në të dhënat e Eurostat: gjatë vitit 2020, numri i aplikimeve të shtetasve shqiptarë që kërkojnë azil në vendet e BE-së, ishte: 5,685 aplikime për azil; 2,540 aplikime janë bërë në Francë; 1,080 aplikime në Gjermani; 990 aplikime në Greqi dhe 345 aplikime në Itali.

Në këtë drejtim vërehet një rënie e konsiderueshme krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019, kur kemi patur 19,310 aplikime për azil;

Grafik.1




Burimi Eurostat

Rol në rënien e këtij fenomeni kanë patur edhe masat e marra nga Ministria e Brendshme, ***si vijon:***

✓ Ministria e Brendshme në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) dhe institucionet e tjera përgjegjëse, kanë filluar që prej 1 Janarit 2020 Projektin "Parandalimi i migrimit të pasigurt nga Shqipëria drejt Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian - Fushata Ndjekëse", financuar nga Mbretëria e Vendeve të Ulëta, si dhe në bashkëpunim me MASR, MSHMS, MFE dhe IOM, gjatë muajit tetor-nëntor 2020, zhvilluan takime informuese në 12 qarqet e vendit me temë "Zgjidhni Mundësitë! Stop Migracionit të parregullt", ku:

- 300 persona në 12 rajone të Shqipërisë nga shërbimi social shtetëror, mbrojtja e fëmijëve, zyrat e punësimit, shëndetësia e sportit migracioni, arsimi, policia e shtetit, policia kufitare, etj. u informuan mbi mundësitë për migrim të rregullt;
- 1,497 mjekë u informuan me shpërndarjen e mesazheve, fletëpalosjeve dhe video.
- 346 shkolla të mesme u informuan me shpërndarjen e mesazheve, fletëpalosjeve dhe video.
- 23,595 nxënës dhe 5 ,926 mësues në shkollat e mesme u informuan me shpërndarjen e mesazheve, fletëpalosjeve dhe videove.
- 25,712 postime në Facebook.
- 100,000 kopje të fletëpalosjes u shpërndanë për të gjitha strukturat e përfshira në zbatimin e fushatës nga shërbimi social shtetëror, mbrojtja e fëmijëve, zyrat e punësimit, shëndetësia e sportit migracioni, arsimi, policia e shtetit, policia kufitare etj.
- Të gjitha aktivitetet janë zbatuar në përputhje të rreptë me masat për situatën Covid-19. Ky projekt ka shtrirje kohore për një vit, pra, deri më 31 Dhjetor 2020;
- Gjithashtu janë kryer informime të detyrueshme të shtetasve shqiptarë të ripranuar, për t'i ndërgjegjësuar për pasojat e migrimit të parregullt dhe për t'u dhënë informacion mbi shërbimet publike dhe jopublike që lehtësojnë ri-integrimin e tyre.
- Nga strukturat përgjegjëse të MB aktualisht po zbatohen: Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 640, datë 20.12.2019, që ka synim "përcaktimin e rregullave të veçanta të kalimit të shtetasve shqiptarë të mitur në kufi" dhe Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr. 641, datë 20.12. 2019, që synon të forcojë kontrollin e shtetasve shqiptarë në dalje të kufirit

shtetëror, që nuk plotësojnë kushtet e udhëtimit për hyrjen dhe qëndrimin në vendet e Bashkimit Europian dhe zonës Shengen;

Aktet e sipërpërmendura parashikojnë masa për forcimin e kontrolleve kufitare të shtetasve që udhëtojnë drejt vendeve anëtare të BE-së/Schengen, duke kërkuar plotësimin e të gjitha kushteve që kërkohen për të udhëtuar drejt këtyre vendeve, si dhe duke qenë se çështja e të miturve të pashoqëruar, mbetet çështja më e ndjeshme që lidhet me fenomenin e azilkërkimit abuziv, përcaktojnë rregulla të veçanta për kalimin e kufirit nga kjo kategori vulnerabël.
Në kuadër të Ditës Evropiane kundër trafikimit të personave, në muajin tetor, i nominuar *"Muaji i Luftës kundër Trafikimit të Personave"*, në bashkëpunim me strukturat shtetërore dhe joshtetërore u zhvilluan aktivitete sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese për parandalimin e trafikimit të personave.

Aktivitetet patën për qëllim që të sjellin në vëmendje të të gjitha strukturave shtetërore, por jo vetëm, rëndësinë e ndërmarrjes së një angazhimi të përbashkët në luftën kundër trafikimit të personave, si dhe të përcjellin mesazhe të forta sensibilizuese për rreziqet që sjell trafikimi, rrugët dhe format për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, në veçanti të grupeve vulnerabël.

Veprimtaritë u fokusuan kryesisht në:

- forume e grupe diskutimi me profesionistë, studentë dhe përfaqësues nga komuniteti;
- aktivitete ndërgjegjësuese/sesione informuese me nxënës të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare, studentë, përfaqësues nga komuniteti, nga strukturat shtetërore dhe joshtetërore, psikologë, punonjës socialë;
- ekspozita rajonale me punime të nxënësve të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare;
- takime ndërgjegjësuese për parandalimin e trafikimit të personave dhe migracionit të parregullt me punonjës të policisë, shërbimit social shtetëror, punonjës të shërbimeve sociale në bashki, punonjës të sistemit arsimor, shëndetësor, psikologë, punonjës socialë, përfaqësues nga komunitetit rom dhe egjiptian, përfaqësues nga biznesi, etj.;
- marshime sensibilizuese në qarqe;
- shpërndarje materialesh informuese dhe ndërgjegjësuese lidhur me fenomenin e trafikimit.

Gjithsej u zhvilluan 196 takime/workshope /sesione/aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese lidhur me: kuadrin ligjor dhe institucional antitrafikim, format, metodat e fenomenit të trafikimit të personave, asistenca, mbrojtja dhe shërbimet për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, mënyrat e raportimit, etj.

❖ Misioni i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është garantimi i zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në përmbushje të tij, Zyra funksionon si mekanizëm për vendosjen e ekuilibrit mes këtyre dy të drejtave kushtetuese. Parimet dhe tiparet thelbësore të saj janë pavarësia, paanësia, besueshmëria dhe transparenca ndaj publikut. Ushtrimi i të drejtës për informim në mënyrë proaktive nxit transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike, si një nga shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës.
✓ Zyra e Komisionerit, gjatë këtij viti, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ka vijuar monitorimin e autoriteteve publike, të cilat kanë hartuar dhe/ose përditësuar programin e transparencës, forcimin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit,

përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, shqyrtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve administrative, seancave dëgjimore dhe dhënien e rekomandimeve e vendimeve.

✓ Të gjitha materialet ndërgjegjësuese me karakter informues në lidhje me fushën e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit"), janë të publikuar në faqen zyrtare, në adresat:
https://www.idp.al/broshura-e-drejta-per-informim/
https://www.idp.al/broshura-mbrojtja-e-te-dhenave-personale/

*E drejta për informim:*

✓ Lidhur me këtë aktivitet, Zyra e Komisionerit, ka hartuar dhe publikuar Newsletter mujor "*E drejta për informim*", e cila është një përmbledhje mujore, me karakter informues, mbi mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit.
Newsletter mund të konsultohen në linkun: https://www.idp.al/newsletter/

✓ Gjithashtu, duke marë shkas nga situata e shkaktuar nga COVID–19, Zyra e Komisionerit është angazhuar në publikimin e një posteri me temë, "*Transparenca në distancë*", i cili ka si qëllim ndërgjegjësimin e Autoriteteve Publike, për të qenë sa më proaktiv edhe në kushtet e pandemisë.

✓ Zyra e Komisionerit ka organizuar gjatë trajnime online me Autoritetet Publike, mbi zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit në kushtet e pandemisë, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për ti kushtuar rëndësi përditësimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës dhe "Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve", instrumente të rëndësishme në funksion të transparencës dhe llogaridhënies së administratës publike. Tematika e trajnimeve ishte "Transparenca gjatë pandemisë", dhe është realizuar me institucionet si më poshtë:

1. *Takim online me koordinatorët e Ministrive;*
2. *Takim online me koordinatorët e Institucioneve te Pavarura;*
3. *Takim online me koordinatorët e Bashkive Qendër Qarku.*

✓ Gjithashtu është zhvilluar takim online me koordinatorët e bashkive, me temë "*Regjistri elektronik për të drejtën e Informimit*", me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për të instaluar Regjistrin Elektronik në sa më shumë institucione të nivelit vendor.

✓ Në të njëjtën kohë, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), Zyra e Komisionerit ka organizuar trajnimim me temë "*E drejta e Informimit dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale*", me pjesëmarrjen e një grupi nëpunësish civilë të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND) nga institucione të ndryshme. Trajnimi kishte në fokus njohjen me kuadrin ligjor të kësaj fushe, parimet kryesore të përpunimit të të dhënave personale, të drejtat e subjektit të të dhënave (individit) si informimi, aksesi, korrigjimi, etj., apo detyrimet e kontrolluesit për një proces të sigurt. Njëkohësisht, të pranishmit u njohën edhe me risitë e legjislacionit ndërkombëtar në këtë fushë, kryesisht me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (GDPR) në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu u nënvizua rëndësia për marrjen e të gjitha masave për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve nga kontrollues publik dhe privat, veçanërisht, në situatën e fundit të krijuar prej pandemisë së COVID-19.

*Mbrojtja e të dhënave personale:*

✓ Në Ditën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme

Profesionale TIK “Hermann Gmeiner”, organizuan konkursin me temë “*Të rinjtë dhe privatësia*”. Ky projekt është një sistem monitorimi mbi frekuentimin e mësimit, për të vënë në dijeni prindin. Aplikacionet e tjera të prezantuara në konkurs përfshijnë disa fusha, si ajo e menaxhimit të financave personale apo të biznesit; menaxhimin e të dhënave shëndetësore apo respektimin e dietave ushqimore; lundrimin e sigurt në internet; blerjeve online; kontrollin e postës elektronike; targimin e automjeteve apo parkimin e tyre.

❖ Përvoja 10 vjeçare e aktivitetit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vuri në dukje domosdoshmërinë e ndryshimeve ligjore për sa i përket Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Pas një konsultimi të gjatë me grupet e interesit dhe shoqërinë civile, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i drejtohet Kuvendit te Shqipërisë, me kërkesën për disa ndyshimeve ligjore të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nëpërmjet Ligjit Nr. 124/2020 miratoi këto ndryshime.

✓ Gjatë vitit 2020, KMD ka nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi me:

- AMA, me qëllim rritjen e bashkëpunimit midis palëve në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, në fushën e mediave audiovizive.
- AIPA, me qëllim komunikim dhe shkëmbim personeli akademik, informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët.

✓ Trajnimin me temë: “Forcimi i shërbimeve ligjore falas për njerëzit në nevojë. Standardet Ndërkombëtare të aksesit në drejtësi dhe përvojat e ofruesve të shërbimeve”. Ky aktivitet u organizua nga Qendra për Nisma Ligjore në kuadër të projektit: “Rritja e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë përmes ndihmës ligjore falas, edukimit ligjor dhe rrjetëzimit të OJF-ve dhe institucioneve”, me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD. Në këtë aktivitet, i cili u realizua në një platformë online kishte si pjesëmarrës ofrues të shërbimeve ligjore, duke përfshirë këtu përfaqësues të organizatave që ofrojnë shërbime ligjore falas për shtresat në nevojë dhe OJF, të cilat ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës në familje dhe që i asistojnë ato në ndjekjen e procedurave ligjore.

✓ Komisioneri ka qenë shumë aktiv për sa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Ai ka qenë i pranishëm në aktivitete te organizuara nga shoqëria civile me temë mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna seksuale, si dhe në protestën e mbajtur për këtë qëllim.

✓ Komisioneri bën publikimin e vazhdueshëm të vendimeve dhe rekomandimeve që ai nxjerr, si dhe gjithë aktiviteti i institucionit të KMD.

✓ Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD-së, parashikuar nëpërmjet një sërë kompetencash për këtë qëllim, si: nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuar.

✓ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kryer dalje publike në media për promovimin e luftës kundër diskriminimit dhe të drejtave të njeriut me fokus rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik.

✓ Komisioneri ka bërë rikonfigurimin e Web-it të institucionit, plotësimin e vazhdueshëm me informacione, vendime, rekomandime dhe gjithë aktiviteti i institucionit të KMD. Një prezencë aktive KMD ka edhe në rrjetet sociale, ku përveç prezantimit të punës së saj, bëhet edhe komunikimi me publikun.

✓ Komisioneri ka qënë në lidhje të ngushtë me Universitetet dhe ka marrë pjesë aktive në takimet e organizuara me ta.

❖ Institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer gjatë vitit 2020 në ushtrimin e funksioneve kryesore, atë të mbrojtjes, promovimit dhe të garantimit të të drejtave të njeriut, në kontekstin e angazhimit për raportim lidhur me Planin e Veprimit 2020-2023 Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun.

*Promovimi i të drejtave të fëmijëve në kontekstin COVID-19*

Gjatë situatës së jashtëzakonshme, të pandemisë COVID-19, Avokati i Popullitdhe Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, ka luajtur rol proaktiv në drejtim të promovimit të të drejtave të fëmijëve me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e institucioneve të administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor, në ushtrimin e detyrave të tyre funksionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Zhvillimi i veprimtarive promovuese të SMPDF gjatë situatës së jashtëzakonshme, të pandemisë COVID-19, është realizuar nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të AP dhe KMPDF të deklaratave të përditësuara lidhur me situatën e COVID-19.

✓ SMPDF nëpërmjet faqes zyrtare të facebook-ut dhe komunikimit zyrtar *on-line*, ka sjellë në vëmendje të institucioneve përgjegjëse shtetërore sugjerimet dhe rekomandimet përkatëse për organet e administratës shtetërore, si pjesë e rrjetit të integruar të mbrojtjes së fëmijës me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e jetës së fëmijëve në përputhje me profilin dhe ka rekomanduar lidhur me problematikat e mësimit online, qasjen tek fëmijët kur nuk kanë kanë akses në internet ose në telefoni mobile, masat që duhet të marrë qeverisja vendore për përballimin e pandemisë, mbrojtjen e fëmijëve të vendosur në institucionet e përkujdesit social rezidencial, mbrojtjen e fëmijës nga dhuna në familje si pasojë e masave kufizuese dhe izolimit të familjeve në shtëpi, mbrojtjen e fëmijës nga dhuna si pasojë e lundrimit në internet për një kohë të gjatë e të vazhdueshme, pa filtra sigurie si rrjedhojë e procesit të edukimit në platformën *on-line*, garantimin e të drejtës së jetës dhe zhvillimit normal të fëmijës si rrjedhojë e kushteve të vështira social-ekonomike, që patsjell situata e pandemisë COVID-19.

✓ Një ndër nismat, që SMPDF ka ndërmarrë gjatë këtij viti, është informimi i fëmijëve për të kuptuar COVID-19, si dhe si të menaxhojnë emocionet në këtë situatë, në një gjuhë të thjeshtë dhe miqësore për ta.

✓ Tryeza e punës "Për edukimin për/rreth të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe fëmijëve në veçanti në programet mësimore" u organizua në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit si nxitës në përfshirjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në programet mësimore si dhe zbatimin e tyre në institucionet arsimore, por edhe si anëtar në Mekanizmin Institucional për Edukimin Ligjor të Publikut (ELP).

*Inspektimet në institucionet e edukimit, institucionet e përkujdesit social për fëmijë dhe në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit të të miturve në konflikt me ligjin dhe të privuar nga liria.*

✓ SMPDF në institucionin e Avokatit të Popullit, kreu inspektime në institucionet e edukimit, institucionet e përkujdesit social për fëmijë dhe në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit të të miturve në konflikt me ligjin dhe të privuar nga liria.

✓ Masat kufizuese të ndërmarra nga autoritetet për qëndrimin në shtëpi, për parandalimin e përhapjes së COVID-19, rritën angazhimin e institucionit të Avokatit të Popullit dhe SMPDF, në lidhje me informimin e fëmijëve rreth masave të parandalimit të efekteve negative, si dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre, gjendje kjo e diktuar nga COVID-19. Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve në institucionin e AP-së është përpjekur të sjellë në vëmendje dhe informacionin e duhur në përputhje me udhëzimet shpjeguese, të përgatitura nga

UNICEF, OBSH, apo organizata ndërkombëtare të ndryshme, për të lehtësuar pasojat e ankthit, stresit e frikës, që mund t'u shkaktohet fëmijëve nga situata e pandemisë, për të mbrojtur më mirë fëmijët tanë, dhe për t'i shpjeguar më mirë Coronavirus-in për ta, në gjuhë të thjeshtë dhe miqësore.

*<u>Mekanizmi Kombëtar kundër Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor (MKPT)</u>*

- ✓ Në bashkëpunim me UNHCR, në përmbyllje të vitit 2020 është në fazën përfundimtare të botimit të fletëpalosjeve informuese mbi veprimtarinë e Avokatit të Popullit, si dhe të drejtës për informim të migrantëve, mbi fazat e procesit të përzgjedhjes dhe të drejtat e emigrantëve, etj, të cilat do të shpërndahen përgjithësisht në të gjitha pikat kufitare që kanë kontakte më të shpejta për emigrantët, por jo vetëm.

*<u>Seksioni i Përgjithshëm</u>*

- ✓ Në kuadër të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Plani i Veprimit për edukimin ligjor të publikut për shkak të situatës së pandemisë për shkak të Covid-19, shumë prej aktiviteteve të parashikuara për tu zhvilluar nga Seksioni i Përgjithshëm/AP si (ditë hapura nëpër bashki të ndryshme, takime me grupe të disavantazhuara si gra e vajza të dhunuara, gra kryefamiljare, persona të komunitetit LGBTI, Persona PAK, Rom dhe Egjiptian dhe të moshuar, etj) nuk mund të zhvilloheshin për të respektuar protokollet e vendosura nga MSHMS dhe ISHP.
- ✓ Seksioni i Përgjithshëm ka vijuar punën për edukimin e publikut lidhur me barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje si dhe të drejtat e komunitetit LGBTI, PAK, Romët dhe Egjiptianët dhe të moshuarit, përmes publikimit në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit te Popullit, apo nëpërmjet mediave sociale (facebook), të deklaratave dhe qëndrimeve të institucionit për respektimin e të drejtave të grupeve të ndryshme, të informacioneve të nevojshme si numra telefoni apo adresa e-maili të institucioneve përgjegjëse për garantimin e të drejtave dhe të sigurimit të mbështetjes për keto grupe vulnerable të shoqërisë.
- ✓ Gjatë periudhës së pandemisë janë hartuar dhe dërguar një sërë rekomandimesh të përgjithshme sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese për strukturat shtetërore me qëllim marrjen e masave dhe respektimin e të drejtave të njeriut për kategori të ndryshme, si për emigrantët që kërkonin të ktheheshin në atdhe pas mbylljes së kufijve për shkak të pandemisë, si dhe miratimin dhe botimin e akteve me efekt kufizues të lëvizjeve të popullsisë.

Seksioni i Administratës mbetet i angazhuar në trajtimin dhe shqyrtimin korrekt dhe brenda një afati të arsyeshëm të të gjitha këtyre çështjeve, mbi ecurinë e punës një vjeçare të seksionit në kuadër të edukimit ligjor.

- ❖ Me synim informimin e shtetasve, në web zyrtat të MEPJ dhe Misioneve Diplomatike e Posteve Konsullore të RSh-së, publikohet informacion mbi lëvizjen e lirë të shtetasve shqiptarë, afatet e qëndrimit pa vizë, motivet e qëndrimit, dokumentacioni i nevojshëm etj. Çdo përditësim informacioni pasqyrohet në web-in zyrtar, nga ku mund të aksesohet prej të gjithë shtetasit shqiptarë të interesuar.

❖ Gjatë vitit 2020, DHASH me mbështjen e organizatës Terre des Homme ka përgatitur:

✓ një Udhëzues për Avokatë mbi "Drejtësinë Miqësore për të Miturit dhe rolin e Avokatit në aplikimin e drejtësisë restauruese, masat alternative si shmangia dhe ndërmjetesimi për të miturit në konflikt me ligjin";

✓ një Modul Trajnimi për "Rolin e Avokatit në Aplikimin e Drejtësise Restauruese dhe alternativat e tjera të dënimit për të miturit në konflikt me ligjin";

✓ në Tetor 2020 është zhvilluar trajnimi me avokatët që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga Shteti.

✓ Lidhur me specializimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore, është zhvilluar trajnimi i avokatëve mbi të drejtat e fëmijëve, veçanërisht të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, në bashkëpunim me Programin HELP të Këshillit të Europës - në datat 12-13 Tetor 2020, u zhvillua Kick off seminar online mbi "Drejtësinë miqësore për të Miturit dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur" për specializimin e avokatëve të listës së ndihmës juridike.

❖ Në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia e Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë u ngrit grupi i punës me Urdhrin nr. 348, datë 27.11.2020 "Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e masave dhe aktiviteteve, të planit të veprimit 2020-2023 në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023". Në kuadër të raportimeve, bazuar në urdhrin e sipërcituar, përgjegjës për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit 2020-2023 në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023, janë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP).

✓ Prej vitesh MASR dhe ASCAP janë të përfshirë në edukimin ligjor të nxënësve dhe të trajnimit të mësuesve përmes veprimtarive të kryera në kuadër të zbatimit të politikës arsimore. ASCAP ka bashkëpunuar përmes specialistëve të saj me OJF të ndryshme si me Fondacionin për zgjidhjen e konflikteve dhe pajtimin e mosmarrëveshjeve, në lidhje me sensibilizimin e mësuesve dhe nxënësve për konceptin dhe praktikën e drejtësisë restauruese dhe për Kodin Penal për të miturit.

✓ Në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës është hartuar një draft udhëzues për përgatitjen e një baze ligjore për trajtimin e çështjeve që lidhen me fenë në shkollë, jashtë kurrikulës. Drafti është gati për diskutim në nivele më të larta.

✓ MASR ka firmosur marrëveshjen me Sekretarin e Shtetit për Ministrinë e Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar për të zhvilluar një paketë mësimore për Krimin e organizuar dhe Krimet e rënda.

✓ Në zbatim të detyrave të ASCAP në kuadrin e zbatimit të Strategjisë së Edukimit Ligjor të publikut, është ngritur grupi i punës për rishikimin e programeve të trajnimit të mësuesve. Një pjesë e këtij grupi është përgjegjës për hartimin e kurrikulës së lëndës "Qytetaria" për arsimin parauniversitar. Në përbërje të këtij grupi pune ka përfaqësues ekspertë të arsimit dhe të fushës ligjore konkretisht nga Qendra e Shërbimeve Arsimore, ASCAP, mësuese anëtare e rrjetit profesional të mësuesve të shkencave shoqërore, DPAP si dhe konsulentë ligjorë personel akademik nga institucionet e arsimit të lartë.

✓ DPAP në kuadër të monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit si dhe referuar ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore", ka siguruar mësimdhënien e njohurive të nevojshme që të ndihmojnë në promovimin, nxitjen dhe formimin e edukatës së barazisë si dhe në ndalimin e

diskriminimit për shkak të gjinisë. ZVAP dhe institucionet arsimore janë përgjegjës për referimin e stereotipeve negativë, paragjykimeve dhe praktikave zakonore ose të çdo lloji tjetër, që cënojnë parimet e barazisë gjinore.

❖ **EUROPEAN CENTRE**

✓ Ngritja e një platforme online me module trajnimi video dhe audio mbi të drejtën për të mos u diskriminuar, ligjin për sinjalizuesit, diskriminimin në administratën publike, etj.

✓ Hartimi i një aplikacioni me informacion mbi barazinë gjinore, të drejtat kushtetuese të grave, të drejtat për punë, etj.

✓ Eventet lançuese të platformës 'tedrejtatemia.al'.

✓ Ditë të Hapura për informimin e qytetarëve se ku duhet të drejtohen për problematika të ndryshme – Klinika e Ligjit.

❖ Qendra **"Të Ndryshëm & Të Barabartë"** (D&E) bashkëpunon ngushtë me Institucionet dhe agjencitë e tjera për aspekte të ndryshme të mbrojtjes së kategorive në nevojë dhe zbaton disa projekte për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit, dhunës në familje, shfrytëzimit të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre, si dhe rritjes së aksesist në drejtësi të viktimave të veprës penale. Projektet e zhvilluara kanë aktivitete ndërgjegjësues për informimin dhe edukimin ligjor të kategorive në nevojë, në veçanti të viktimave të trafikimit, viktimave të dhunës, viktimave të abuzimit seksual dhe fëmijëve.

✓ Qendra "Të Ndryshëm & Të Barabartë" është autorizuar për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore me urdhër nr. 302 datë 10.09.2020 të Ministrit të Drejtësisë. Duke filluar nga muaji shtator dhe në vazhdim janë realizuar raportimet përkatëse pranë Ministrisë së Drejtësisë.

✓ Gjatë vitit 2020 janë realizuar aktivitete sensibilizuese në bashkëpunim me organizata të tjera dhe me Qendrën Sociale të Shkozës (Organizata "ShKEJ" fushatë sensibilizuese me aktivistët e këtij organizate dhe me Organizatën "Tek Urat") fushatë sensibilizimi.

## Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.4

| **Statusi aktual i masave të Objektivit Strategjik.4** | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të masave të Objektivit Strategjik.4** | **Numri i masave** | **Përqindja ndaj totalit** |
| Të zbatuara | 2 | 16.7% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 5 | 41.6% |
| Të pazbatuara | 0 | 0% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 2 | 16.7% |
| Të paraportuara | 3 | 25% |
| **Totali** | **12** | **100%** |







***Rezulton se nga 12 masa të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin strategjik 4, 2 masa janë të zbatuara, 5 janë pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi, 2 masa janë jashtë periudhës së raportimit (në vitet në vijim), si dhe 5 masa të pa raportuara nga institucionet përgjegjëse.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Objektiv, është në nivelin 16.7% të zbatuara, 41.6% pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi, 16.7% jashtë periudhës së raportimit (në vitet në vijim), si dhe 25% të pa raportuara nga institucionet përgjegjëse.

## 2.4 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

***Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), për arritjen e Objektivave Strategjikë, duhet të përmbushë edhe 16 objektivat specifikë si tregues të arritjeve.***

**Statusi aktual i Objektivave Specifikë**

| **Statusi aktual i 16 Objektivave Specifikë** | | |
|---|---|---|
| **Statusi i zbatimit të Objektivave Specifikë** | **Numri i Objektivave Specifikë** | **Përqindja ndaj totalit të Objektivave Specifikë** |
| Të zbatuara | 1 | 6.25% |
| Pjesërisht të zbatuara/në proces | 12 | 75% |
| Të pazbatuara | 0 | 0% |
| Jashtë periudhës së raportimit | 2 | 12.5% |
| Të paraportuara | 1 | 6.25% |
| **Totali** | **16** | **100%** |






***Rezulton se nga 16 objektiva specifikë të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë, 1 objektiv specifik është i zbatuar, 12 janë pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi, 2 objektiva specifikë janë jashtë periudhës së raportimit (në vitet në vijim), si dhe 1 objektiv specifik rezulton i pa raportuara nga institucionet përgjegjëse.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për objektivat specifikë, është në nivelin 6.3% të zbatuara, 75% pjesërisht të zbatuara/ në proces zbatimi, 12.5% jashtë periudhës së raportimit (në vitet në vijim), si dhe 6.25% të pa raportuara nga institucionet përgjegjëse.

Më poshtë paraqitet një informacion mbi procet e Edukimit Ligjor nga institucinet e pavarura të Sistemit të Drejtësisë.

*(KLP)Këshilli i Lartë i Prokurorisë*

Në kuadër të së drejtës së informimit, KLP ka përgatitur dhe publikuar në faqen e web-it, një seri dokumentacioni që lidhet me organizimin e brendshëm të institucionit, ku përfshihen: përbërja e këshillit, organigrama, vendimet me karakter administrativ të Këshillit, aktet nënligjore të miratuara, struktura e pagave, detajimi i buxhetit, Projekt-Buxheti Afat-Mesëm (2020-2022), Raporti Vjetor për Kuvendin (në shqip dhe anglisht), përmbledhja e paketës ligjore të Reformës në Drejtësi, në të cilën janë përfshirë të gjithë aktet ligjore, etj.

Gjithashtu KLP, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, ka caktuar një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit. Në këtë kontekst, KLP i është përgjigjur kërkesave për informim në mënyrë sistematike, brenda afateve ligjore, personave fizikë dhe juridikë (organizata jofitimprurëse, organe mediatike etj.).

Sa i përket përmbajtjes së vendimmarrjeve të KLP në mbledhje plenare, në kuadër të transparencës kundrejt publikut, vendimet e Këshillit janë publikuar në faqen zyrtare të web-it, ndërsa regjistrimi

audio i mbledhjes plenare është bërë publik në faqen zyrtare brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes, në zbatim të Ligjit për qeverisjen, neni 167, pika 2.

Para shpalljes së gjendjes së pandemisë Covid-19, në mbledhjet plenare të Këshillit kanë qenë të pranishëm si vëzhgues, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe partnerë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Seancat plenare të Këshillit janë ndjekur në kohe reale nga mediat dhe janë zhvilluar në prezencë të tyre, para dhe pas përfundimit të tyre. Pas shpalljes së pandemisë Covid-19, mbledhjet plenare të KLP janë zhvilluar nëpërmjet platformës online dhe disa seanca plenare nëpërmjet vendimeve qarkulluese. Në faqen zyrtare të Këshillit është publikuar axhenda e çdo mbledhjeje, vendimet e marra, si dhe regjistrimi audio, sipas procedurës së sipërcituar.

Njoftimet për mediat, konferencat për shtyp, intervistat dhe aktivitetet të tjera të KLP (ceremonia e betimit të prokurorëve të rinj, takime me përfaqësues të prokurorive të rretheve gjyqësore, takime me përfaqësues diplomatik, pjesëmarrje në trajnime, seminare, takime bilaterale etj.) janë pasqyruar në faqen zyrtare të Këshillit.Për ta bërë komunikimin me publikun sa më të frytshëm, pavarësisht se KLP nuk ka detyrime konkrete për edukimin ligjor të publikut sipas Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), në fund të muajit Shtator 2020, KLP ka prezantuar Strategjinë e Komunikimit të KLP. Ky dokument u hartua posaçërisht për zhvillimin dhe përmirësimin e komunikimit me publikut dhe atë institucional dhe ndërinstitucional. Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Europës për komunikimin me median dhe publikun për gjykatat dhe prokuroritë, hartimi i strategjisë së komunikimit synon rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

*(PP) Prokuroria e Përgjithshme*

Lidhur me objektivat strategjikë të Edukimit Ligjor për Publikun, miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 47, datë 18.04.2019, në përmbushje të detyrimit ligjor parashikuar në nenin 61 të ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" dhe në kuadër të organizimit institucional, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm është caktuar prokurori për marrëdhëniet me publikun.

Në plotësim të kuadit normativ, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar Udhëzimin e Përgjithshëm nr.5, datë 30.07.2019 "Marrëdhëniet me Publikun në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm", me synim unifikimin e marrëdhënieve me publikun dhe median në veprimtarinë e prokurorive dhe rritjen e transparencës, si një mundësi që publiku të njohë punën e prokurorisë në mbrojtje të të drejtave të tij, për rritjen e besimit të publikut në sistemin e prokurorisë dhe inkurajimin për pjesëmarrjen e tij në parandalimin dhe denoncimin e krimit si dhe në procesin e reformave në të cilat prokuroria është e përfshirë, duke ruajtur integritetin, pavarësinë e paanësinë, sekretin hetimor, parimin e rëndësishëm të prezumimit të pafajësisë, mbrojtjen e të drejtave të të miturve si dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Nga ana tjetër, çdo akt normativ i Prokurorit të Përgjithshëm publikohet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

*KLGJ (Këshilli i Lartë Gjyqësor)*

Duke vlerësuar shumë faktin se njohuritë mbi ligjin dhe edukimi ligjor i qytetarëve ka një rol të rëndësishëm në demokratizimin e shoqërisë, ku qytetarët të kuptojnë më së miri të drejtat e tyre ashtu dhe rregullat e përcaktuara, dhe prej nga ku të nisin të kërkojnë lidhur mbi këto drejta apo dhe t'i respektojnë ato, edhe KLGJ i ka dhënë një rëndësi të veçantë aksesit të publikut në njohuritë mbi ligjin, si një premisë për një sistem drejtësie efektive.

Ndaj dhe KLGJ në ushtrimin e veprimtarisë së tij, mban në konsideratë që qytetarët por dhe subjektet e vendimmarrjes së tij të kuptojnë rolin, kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij institucioni të ri të krijuar nga ndryshimet kushtetuese miratuar në gusht të vitit 2016. Angazhim i thellë i KLGJ dhe i stafit administrative të tij ka qenë në të gjithë komunikimet, trajtimet e kërkesë/ankesave të ardhura nga publiku apo dhe institucione të ndryshme, ku janë informuar dhe janë orientuar lidhur me mënyrën e trajtimit të kërkesave/ankesave të tyre, rolin dhe e secilit prej institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë të krijuar në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i angazhuar për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, si një ndër objektivat e tij kryesorë. Këshilli i Lartë Gjyqësor synon përmirësimin e marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun, lehtësimin e të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, të mënyrës së marrjes së vendimeve dhe kufizimet në punën e gjyqtarëve. Transparenca, ndershmëria, llogaridhënia dhe besueshmëria janë parimet udhëheqëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe komunikimi do të kryhet në mënyrë profesionale, në çdo kohë. Përtej vlerave thelbësore të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave, vendimmarrja e përditshme e gjyqësorit është e drejtuar nga këto parime të rëndësishme, si dhe: Aksesi, Efektiviteti, Efikasiteti, Barazia, Dinjiteti, Drejtësia, Besueshmëria, Respekti dhe Transparenca.
Ligji Nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë" parashikon krijimin e pozicioneve të reja në gjykata, duke përfshirë disa pozicione kryesore për komunikimin me median dhe publikun.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, përmes Anëtarit të tij të Caktuar për Kryerjen e Detyrave në Lidhje me Marrëdhëniet me Publikun, Gjyqtarëve të Medias dhe Nëpunësve për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun (NMMP) në gjykata, kanë për detyrë të sigurojnë që informacioni që i ofrohet publikut të jetë i saktë dhe në kohë, duke përdorur një sërë mjetesh, përfshirë edhe faqet e internetit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë dhe për zbatim të nenit 91 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë", me vendimin nr. 68 datë 24.04.2019 ka caktuar anëtarin për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, si dhe me vendimin nr. 280 datë 10.12.2019, ka caktuar gjyqtarët për median për çdo juridiksion apeli.

Me qëllim garantimin e parimeve udhëheqëse të komunikimit të sistemit gjyqësor, aksesi, komunikimi profesional, besueshmëria, përgjegjësia, transparenca, ndershmëria, llogaridhënia si dhe angazhimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor për rikthimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, është **hartuar "Plani strategjik i komunikimit për sistemin gjyqësor"[23],** në të cilin pasqyrohet vizioni dhe misioni; vlerat thelbësore të gjyqësorit; qëllimet e komunikimit, parimet kryesore të komunikimit të gjyqësorit; roli i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i gjyqtarit të medias, i nëpunësit të marrëdhënieve me median dhe publikun (NMMP), i bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, i faqeve të internetit të gjykatave, i mediave sociale në zbatimin e parimeve të komunikimit si dhe sfidat e mundësitë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) tashmë ka filluar punën e rëndësishme për të përmirësuar marrëdhëniet me median dhe publikun brenda gjyqësorit, përmes caktimit të Gjyqtarëve të Medias në 8 gjykata që mbulojnë juridiksionet e apelit të Shkodrës, Vlorës, Korçës, Tiranës, Durrësit, Gjirokastrës, juridiksionin e posaçëm administrativ dhe juridiksionin e posaçëm për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

[23] Miratuar me vendimin nr. 590, datë 26.11.2020 "Për miratimin e "Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor".

Gjithashtu, KLGJ ka parashikuar NMMP në disa prej gjykatave kryesore në vend: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Lartë. Përmes përkrahjes së Projektit të USAID "Drejtësi për të Gjithë", KLGJ ka qenë në gjendje të sigurojë edhe në Gjykatën e Rretheve Gjyqësore Durrës dhe Lezhë nga një NMMP të përkushtuar. Një faqe e re interneti e Këshillit është tashmë funksionale, me informacion të përditësuar në lidhje me Këshillin, anëtarët e tij, vendimet dhe dokumentacionin përkatës. Këshilli i Lartë Gjyqësor është angazhuar për një proces të vazhdueshëm komunikimi me partnerët e mediave dhe ka zhvilluar takimet e para me gazetarët përfaqësues të mediave, si dhe ka planifikuar për të zhvilluar takime të tjera në vijim.

Këshilli, për të garantuar përmirësimin e aksesit, të kuptuarit dhe besimit në gjykatat e Shqipërisë, ka hartuar këtë "Plan Strategjik të Komunikimit" për Informimin e Medias[24] dhe Publikut, dokument i cili do të orientojë veprimtarinë e gjyqësorit shqiptar. Ky plan komunikimi, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe kombëtare, miratohet pas konsultimit me gjykatat, për vetë rëndësinë e tij.

Ekziston një angazhim i qartë për Gjyqtarët e Medias dhe NMMP për të përballuar sfidën e marrëdhënieve me publikun dhe mediat që mbulojnë gjykatat në Shqipëri. Tashmë ka nisur një qasje e re, me njerëzit e përkushtuar për të siguruar informacion të saktë për median dhe publikun, në funksion të përmirësimit të transparencës së veprimtarisë së gjyqësorit.

KLGJ dhe gjykatat janë të përkushtuar të punësojnë profesionistë me kualifikim të lartë për të shërbyer si NMMP dhe të garantojnë që ata janë të trajnuar dhe vënë në zbatim praktikat më të mira për dhënien e informacionit dhe bashkëveprimin me median dhe publikun në mënyrë sa më efikase. NMMP do të punojnë me Gjyqtarët e Medias për të siguruar që veprimet e gjykatave dhe procedurat e shërbimet gjyqësore janë të kuptueshme dhe lehtësisht të disponueshme.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i gatshëm të bëjë gjithçka që mundet, për të siguruar që gjyqësori shqiptar të funksionojë me transparencë të plotë dhe është i përkushtuar për arritjen e standardeve më të larta të përgjegjshmërisë publike në komunikimin me median dhe publikun.

Plan Strategjik për Sistemin Gjyqësor i miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ka një nga objektivat e tij thelbësore, forcimin e marrëdhënieve midis gjyqësorit dhe publikut, ofrimin dhe zbatimin e mënyrave novatore dhe të përshtatshme për palët e interesit, në veçanti përmes sistemeve online, për rritjen e bashkëpunimit me to të KLGJ, personelit administrativ dhe gjykatave; marrjen e një roli aktiv për të ndikuar në politikat publike dhe për të nxitur ndryshimet e duhura specifike, lidhur me mënyrën se si pushtetet e tjera ndër veprojnë me KLGJ, për planifikimin në sistemin gjyqësor; vendosjen e një strategjie komunikimi për të siguruar marrëdhënie transparente, proaktive dhe informuese të medias dhe publikut; publikimin në kohë i vendimeve gjyqësore në portal/faqen e internetit të KLGJ.

### Histori suksesi (përmes masave prioritare)

Ministria e Drejtësisë/ Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit ka organizuar "Javën e Integritetit", një fushatë e rëndësishme dhe e sukseshme për promovimin e integritetit, që është vlera dhe rezistenca më e mirë kundër korrupsionit. Gjithashtu përmes kësaj fushate synohet rritja

[24] Vendim nr. 592, datë 26.11.2020 "Për miratimin e rregullores "Për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median".

e ndërgjegjësimit si dhe promovimi i sjelljes etike, transparencës, llogaridhënies, përgjegjshmërinë si dhe përpjekjet e ndërmarra prej aktorëve të ndryshëm në luftën kundër korrupsionit.
Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr.47, datë 18.4.2019, ka miratuar Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, pjesë e paketës së Reformës në Drejtësi.
Strategjia për edukimin ligjor të publikut synon rritjen e ndërgjegjësimit ligjor publik në Shqipëri, me qëllim që qytetarët të jenë në gjendje të marrin pjesë aktivisht dhe efektivisht në një mjedis social dhe ekonomik të rregulluar ligjërisht.

Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen e Kuvendit është një kompleksitet aktivitetesh, funksioni primar i të cilave është rritja e ndërgjegjësimit për parlamentin si institucion, lehtësimi i shpërndarjes dhe shkëmbimit të informacionit, ideve dhe pikëpamjeve mes qytetarëve dhe organeve të Kuvendit.
Pjesëmarrja e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit është një element i rëndësishëm i asaj që sot ka filluar të quhet "demokracia pjesëmarrëse". Kjo formë demokracie nuk zëvendëson demokracinë përfaqësuese, por e plotëson atë dhe e bën funksionale. Në këtë kuptim, pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit krijon kushtet e nevojshme për qytetarët që të marrin pjesë aktive në jetën politike gjatë gjithë legjislaturës dhe jo vetëm në momentin kur i kërkohet të zgjedhin atë; i krijon mundësinë qytetarëve që të avokojnë për interesat e tyre të ligjshme dhe kështu të kontribuojnë për krijimin e një demokracie të qëndrueshme; detyron institucionin të jetë më transparent dhe afron deputetët më shumë me zgjedhësit; kontribuon në përmirësimin e legjislacionit dhe lehtëson implementimin e tij.

Ligji nr.111/2017, "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti", ka si qëllim të sigurojë akses të barabartë në drejtësi përmes garantimit dhe funksionimit të sistemit të ndihmës juridike falas. Këto detyra të Drejtorisë, tregojnë qartë se fushatat e ndërgjegjësimit, informimi i publikut mbi sistemin e ndihmës juridike, kushtet për përfitimin e saj si dhe bashkëpunimi me aktorët kryesorë të përcaktuar në ligj për ofrimin e ndihmës juridike (OJF, klinikat e ligjit), janë jo vetëm detyra funksionale të përcaktuara me ligj por edhe pjesë përbërëse e misionit të drejtorisë në funksion të mirëadministrimit/mirëfunksionimit të sistemit të ndihmës juridike falas. Thënë këtë, fushëveprimtaria e DNJF-së është ngushtësisht e lidhur me informimin dhe edukimin ligjor të publikut e rrjedhimisht lidhet dhe me Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-23.

## 3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën *1 janar – 30 dhjetor 2020*, rezulton se fushat që kanë treguar performancë jo rezultative të shoqëruar nga problematika për këtë periudhë raportimi, janë aktivitet e pa realizuara/zbatuara.
Në adresimin e performancës nga institucionet, rezulton se mungesa e burimeve njerëzore specifike (kapacitete institucionale); mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e disa veprimtarive të parashikuara; vonesa në kryerjen e procedurave/fazave të kryerjes së aktiviteteve specifike, janë arsye dhe shkaqe që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.
Periudha *janar – dhjetor 2020*, përkoi gjithashtu me një situatë të vështirë shoqërore me efekt global, Pandemia Covid -19, e cila pati ndikimet e saj të menjëhershme edhe në mbarëvajtjen e aktiviteteve institucionale dhe ndërinstitucionale në vend, në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit 2020-2023.

Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2020-2023, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të zbatimit dhe të monitorimit janë:

- Njohja dhe aplikimi i metodologjisë së re të monitorimit dhe raportimit të planit të veprimit në përputhje e agjendën e mirëqeverisjes dhe formatin IPSIS të dokumenteve strategjike. Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dërgohet në përputhje me kategorinë e informacionit, të jetë faktik, të ketë evidenca të qarta dhe të dhëna analitike. Çdo qëllim politikash duhet të ndërlidhet me nivelin e zbatueshmërisë së masave/aktiviteteve dhe buxhetin e planifikuar dhe të buxhetit faktik të përdorur.
- Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.
- Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitucional.
- Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit tek Drejtoritë e Financës, përpara momentit të raportimit.
- Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të raportimit të parashikuara në Strategji.
- Plotësimi i hendekut të evidentuar midis Pasapotës së Indikatorëve dhe Planit të Veprimit, pasi ka institucione/subjekte që nuk janë përgjegjës në Plan Veprimi, por rezultojnë përgjegjës në Pasaportën e indikatorëve.

### *3.3 Konkluzione dhe rekomandime*

Raporti i monitorimit *janar - dhjetor 2020*, në zbatim të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, është dokumenti i parë monitorues që hartohet në përputhje me këtë plan veprimi dhe me një metodologji të re hartimi. Ky dokument është në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjikë sektoriale dhe ndërsektorialë për agjendën e mirëqeverisjes, dhe në kuadër të programimit IPSIS.

Raporti vjetor jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës/objektivave strategjikë, objektivave specifikë të strategjisë, të masave të parashikuara për arritjen e këtyre objektivave, të aktiviteteve konkrete të parashikuara. Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave prioritare të planit të veprimit, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe identifikim të masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim.

Për këtë periudhë zbatimi të Planit të Veprimit, janë parashikuar në total **22** masa e **62** aktivitete.

Nga këto: **7** masa janë të zbatuara plotësisht; **12** masa janë ende në proces zbatimi, **6** masa janë jashtë periudhës së raportimit (për vitet në vijim), si dhe **3** masa të paraportuara nga institucionet përgjegjëse.

Nga këto: **31** aktivitete janë të zbatuara plotësisht; **14** aktivitete janë zbatuar pjesërisht/në proces zbatimi, **1** aktivitet është i pazbatuar, si dhe **16** aktivitete janë të paraportuara nga institucionet përgjegjëse.

Në përfundim të këtij raporti, rekomandimet janë:

- të përmirësohet performanca e aktivitetit të institucioneve që raportojnë masa/aktivitete në proces zbatimi;
- të ulet numri i masave/aktiviteteve që rezultojnë të pazbatuara;
- të brendësohet metodologjia IPSIS e raportimit të zbatimit të masave dhe aktiviteteve për periudhën në zbatim.

# IV. RISQET/RISKU DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR

## 4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit

Në raportet e ardhshme të monitorimit, do të vijojë analiza e treguesve për çdo objektiv për të parë ecurinë e tyre dhe progresin e qëllimeve të politikës sipas të katër Objektivave Strategjikë të SELP.

1. Duhet kushtuar vëmendje realizimit të masave dhe aktiviteteve të lidhura me objektivat respektive specifikë dhe atyre startegjikë.
2. Kuvendi i Shqipërisë dhe Ministria e Drejtësisë, do t'i kushtojë një vëmendje të shtuar për të monitoruar dhe mbështetur kryerjen e aktiviteteve dhe realizimin e masave.
3. Tejkalimi i afateve të raportimit nga institucionet përgjegjëse është problematikë e cila ndikojnë drejtëpërsëdrejti në hartimin e Raporteve të Monitorimit.
4. Problematikë e rëndësishme është cilësia e kontributeve, ku shpesh janë ri-kthyer për t`u plotësuar sipas kërkesave dhe në përputhje me formatin e Planit të Veprimit.
5. Metodologjia e monitorimit sipas IPSIS, kërkon përmirësimin e kapaciteteve në institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin.
6. Gjatë fazës së monitorimit është vënë re një numër i madh pikash kontakti, të cilat kanë raportuar për aktivitete të veçanta të Planit të Veprimit, duke mos u koordinuar brenda institucionit raportues në mënyrë që të dërgohej pranë MD-së një raportim i plotë mbi të gjitha aktivitetet respektive të institucionit përgjegjës.

## *4.2 Hapat e radhës*

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar - dhjetor 2020*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, kërkohet që:

- Të vijojë zbatimi i masave në statusin "zbatuar pjesërisht/në proces" sipas afateve të parashikuara;
- Të nisë zbatimi në kohë i masave/aktiviteteve të parashikuara për periudhën në vijim;
- Të tregohet kujdes për organizimin e punës dhe proceseve përkatëse për ecurinë e masave e aktiviteteve;
- Të sigurohet operativiteti i burimeve dhe kapaciteteve njerëzore dhe ekspertizës së nevojshme për kryerjen e tyre;

- Të garantohen burimet financiare të munguara që ndikojnë në zbatueshmërinë e masave e aktiviteteve;
- Të sigurohet bashkëpunimi institucional i nevojshëm për masa e aktivitete të përbashkëta;
- Të garantohet koordinimi i mjaftueshëm për të shkëmbyer në mënyrë të efektshme informacionin dhe zgjidhur problemet penguese që mund të zgjidhen nga institucionet (përgjegjëse dhe bashkëpunëtore).

## V. Aneksi I: Raporti vjetor i monitorimit për Planin e Veprimit 2020-2023

| Kodi | Objektivat Strategjikë dhe Institucionet Përgjegjëse Respektive | Periudha e zbatimit të Planit të Veprimit | | | Kosto indikative PV | Buxheti i planifikuar për vitin raportues | | Buxheti i përdorur | Progresi deri më tani | | Problematikat | Hapa të tjera | Afati i përfundimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Fundi i vitit | Vlera e Targeti | /OOO total | Totali në % | /OOO total | Totali në % | Buxheti i përdorur deri më tani krahasuar me buxhetin indikativ ( në %) | Jep me % zbatimin për çdo Qëllim Politike dhe Objektiv Specifik | I zbatuar<br>Zbatuar pjesërisht/në proces<br>I pazbatuar | text | text | text |
| 1 | Buxheti total për strategjinë | | | Totali 1+2+3 | 100 | | | | | | | | |
| | **I. QËLLIMI STRATEGJIK: Investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezionin social** | | | | | | | | | | | | |
| 1 | **Objektivi Strategjik 1: Përmirësimi i organizimit dhe funksionimit institucional në ofrimin e ELP-së** | | | Totali 1 | | | | | **35%** | **PJESËRISHT I ZBATUAR/NË PROCES** | | | |
| 1.1 | **Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi i legjislacionit me qëllim parashikimin e parimeve e formave të ELP-së dhe përfshirjen e ELP-së në përgjegjësitë e institucioneve.** | | | | | | | | **35%** | **PJESËRISHT I ZBATUAR/NË PROCES** | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.1.1** | **Raporti i vlerësimit të nevojave për përmirësime të kuadrit ligjor dhe institucional të ELP-së i hartuar** | | **515** | | | | | | | | |
| 1.1.1. a | Ngritja e Grupit Institucional të Punës për kryerjen e studimit mbi nevojat për përmirësime të kuadrit ligjor dhe institucional (I) Hartimi i raportit paraprak mbi nevojat (II) Konsultimi i raportit paraprak me anëtarët e Rrjetit (III) Hartimi dhe publikimi i raportit përfundimtar mbi nevojat për përmirësime të kuadrit ligjor dhe institucional të ELP (IV) | | 515 | | | | | | | | |
| **1.1.2** | **Akte ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe të miratuara, në përputhje me rekomandimet e raportit përfundimtar të vlerësimit të ELP-së** | | **1,193** | | | | | | | | |
| | Ministria e Drejtësisë/Ministritë (anëtarë të Rrjetit) | | | | | | | | | | |
| | 91401AA | | | | | | | | | | |
| 1.1.2. a | Numri i akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara dhe të miratuara | | 1,193 (MD)<br>Ministritë e tjera kosto administrative | | | | | | | | |
| | Ministria e Drejtësisë/Ministritë (anëtarë të Rrjetit) | | | | | | | | | | |
| | 91401AA (MD) 91101AD (MASR) | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.2. b | Numri i akteve nënligjore për NJQV-të: (Rregullorja për konsultimin publik/ Rregullorja për të Drejtën e Peticionit, Ankesave dhe iniciativën qytetare/Rregullorja e Këshillit Bashkiak/Mbështetje për ndërgjegjësimin e bashkive në lidhje me detyrimet mbi ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" /Përmirësimi i akteve ligjore/nënligjore për Prefektin e qarkut<br>*Aktet që do të/mund të ndryshohen do të parashikohen saktësisht në varësi të kërkesave të institucioneve propozuese. | | 4,116 | | | | | | | | |
| | Ministria e Brendshme/Shoqata e Bashkive | | | | | | | | | | |
| | 91602AC | | | | | | | | | | |
| 2 | **Objektivi Specifik 1.2: Rritja e vazhdueshme e burimeve financiare nga buxheti i shtetit dhe donatorët për ofrimin e ELP-së** | | | | | | **35%** | **PJESËRISHT I ZBATUAR/NË PROCES** | | | |
| 1.2.1 | **Aktivitete ndërgjegjësuese dhe advokuese për rritjen e nivelit të financimit të aktiviteteve të parashikuara në PV të SELP nga donatorët, të realizuara** | | 515 | | | | | | | | |
| 1.2.1. a | Krijimi i databazës së donatorëve që mbështesin aktivitete të ELP-së | | 515 | | | | | | | | |
| | MD/Ministritë(anëtarëtëRrjetit) OSHC-të | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 91401AA MD | | | | | | | | | | |
| 1.2.1. b | Zhvillimi i një konference kombëtare për të rritur ndërgjegjësimin e përdorimit të ELP-së | | Kosto administrative. | | | | | | | | |
| | Kuvendi/Ministritë (AnëtarëtëRrjetit) OSHC | | | | | | | | | | |
| | 90202AA Kuvendi | | | | | | | | | | |
| **1.2.2** | **Përmirësimi i planifikimit buxhetor të institucioneve publike dhe përfshirja në prioritetet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) të ELP-së** | | **40,400** | **0%** | **0%** | **0%** | **35%** | **PJESËRISHT I ZBATUAR/NË PROCES** | | | **6M II 2020** |
| 1.2.2. a | Integrimi në prioritetet e AMSHC-së (thirrje për projekte) në fushën e edukimit ligjor të publikut | | 40,400 | 10,100<br>3,880 | 100 %<br>3,880 | 0%<br>100% | **0%**<br>**70%** | **I PAZBATUAR (AMShC)**<br>**PJESËRISHT I ZBATUAR/NË PROCES (QA)**<br>Forume informuese; -Ditë të hapura;<br>-Konkurs me temën "Bashkimi Europian sipas perceptimit tim"; Intervistë televizive – 100%;<br>-Forume online mbi ofrimin e ndihmës juridike parësore;<br>-postera informues me informacion të përgjithshme për shërbimet që përfitojnë qytetarët;<br>- 1video ndërgjegjësuese – 70 % | Me rastin e reduktimit të fondeve institucionale, AMShC, reduktoi edhe fushatat prioritare duke i orientuar ato për nga perballimi i situatës | Me çeljen e vitit te ri buxhetor, AMShC, do të vijojë të publikojë mbështetjen për organizata që promovojnë | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | COVID - 19. | strateg jinë sipas parash ikim. | |
| | AMShC | | | | | | | | | | |
| | 98801 AA | | | | | | | | | | 6M II 2020 |
| 1.3 | **Objektivi Specifik 1.3: Sigurimi i burimeve njerëzore të nevojshme për të mundësuar ndërhyrjen me efektivitet në ofrimin e ELP-së** | | | | | | | | | | |
| 1.3.1 | **Identifikimi e vlerësimi i nevojave për burime njerëzore në nivel qendror dhe vendor** | | **317** | | | | | | | | |
| 1.3.1. a | Përcaktimi i një koordinatori që ofron edukimin/orientimin ligjor të publikut, në institucionet qendrore dhe vendore | | 317 | | | | | | | | |
| | Ministritë (anëtare tëRrjetit) /NJQV | | | | | | | | | | |
| | 91401AA | | | | | | | | | | |
| 1.3.1. b | ELP i të papunëve, kryesisht i grupeve në nevoje mbi legjislacionin në fushën e punësimit, migracionit për motive punësimi dhe arsimit e formimit profesional | | Kosto administrati ve. | | | | | | | | |
| | MFE/ Institucionet e varësisë (Zyrat rajonale dhe vendore të punësimit) | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kodi MFE 10 | | | | | | | | | | |
| | **QËLLIMI STRATEGJIK 2: Garantimi dhe forcimi i bashkëpunimit efektiv ndërinstitucional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për realizimin e ELP-së** | | | | | | **78.76%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| **2.1** | **Objektivi Specifik 2.1: Institucionalizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim koordinimin dhe bashkërendimin e iniciativave të ELP-së** | | | | | Kosto administrative | **98%** | **I ZBATUAR** | | | |
| 2.1.1 | **Krijimi i strukturës (Rrjeti) ndërinstitucionale përgjegjëse për edukimin ligjor të publikut dhe përcaktimi i kuadrit rregullator të veprimtarisë së tij** | | **Kosto administrative** | | | | **100%** | **I ZBATUAR** | | | 6M I 2020 |
| 2.1.1.a | Rregullore e Rrjetit e hartuar dhe e miratuar (I); publikim/njoftim i ngritjes së Rrjetit (II) faqja web e Rrjetit e ngritur dhe funksionale; nr. i publikimeve të kryera në web) | | **Kosto administrative** | | | Kosto administrative | **100%** | **I ZBATUAR (KSH)**<br>Në faqen zyrtare të Kuvendit, është bërë funksional linku i Strategjisë, në të cilin janë publikuar gjithë aktet e miratuara deri tani nga Kuvendi, Rrjeti dhe Komisioni Drejtues, konkretisht:<br>1.Vendimi i Kuvendit për miratimin e SELP<br>2.VKM nr.878, datë 11.11.202 "Miratimin e planit të veprimit 2020–2023, në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun 2019–2023"<br>3.Rregullorja e Rrjetit<br>4.Vendimet e Komisionit Drejtues<br>5. Procesverbalet e mbledhjeve të Rrjetit dhe të Komisionit Drejtues | | | |
| | Kuvendi | | | | | | | | | | |
| | 90202AA | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.2 | **Transparencë e shtuar e veprimtarisë dhe aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të ELP-së** | | **Kosto administrative** | 700 (MTM) | 100 % | 500 (MTM) | **90%** | **I ZBATUAR** | | | 6M I 2020 |
| 2.1.2. a | Përditësimi i faqes *web* të krijuar (I) Hedhja e të dhënave mbi aktivitete që ndërmerren për ELP-në në fushën e legjislacionit sipas fushës së përgjegjësisë së çdo ministrie (anëtarë të Rrjetit) dhe të autoriteteve tjera publike | | Kosto administrative | 700 (MTM) | 100 % | Kosto administrative (KSH, MD)<br>500 (MTM) | **100%**<br>**70%**<br>**100%** | **I ZBATUAR (KSH)**<br>**NË PROCES (MTM)**<br>Në vazhdim të detyrave të përcaktuara në Planin e Veprimit është bërë përditësimi i të dhënave në linkun e krijuar.<br>Ministria e ka rritur vemendjen për edukimin ligjor pas miratimit të akteve, por nuk ka një faqe të dedikuar të ELP. Ndaj e kemi vënë në process dhe realizimin në masën 70%.<br>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hedhur në faqen e saj Aktivitet për edukimin ligjor të publikut që ka zhvilluar në kuadër të ligjit të Pyjeve, Strategjisë për menaxhimin e mbetjeve dhe VKM-të në fushën e turizmit për përdorimin e plazheve.<br>**I ZBATUAR (MD)**<br>Ministria e Drejtësisë, ka publikuar në faqen zyrtare të saj të gjitha aktet nënligjore dhe dokumentat e hartuara në zbatim të drejtësisë penale për të mitur, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me Bashkitë në kuadër të ofrimit të një drejtësie miqësore për të miturit. | Anëtarët e Rrjetit duhet të dërgojnë të dhëna mbi aktivitete që ndërmerren për ELP-në, sipas fushës së përgjegjësisë me qëllim pasqyrimin e tyre në faqen web të Strategjisë | | |
| | Kuvendi/ Autoritete Publike (anëtare të Rrjetit) | | | | | | | | | | |
| | 90202AA (Kuvendi) | | | | | | | | | | 6M I 2020 |
| 2.1.2. b | Aktivitete ndërgjegjësuese e advokuese ndaj institucioneve përgjegjëse për ofrimin e ELP-së me qëllim edukimin ligjor për PAK | | Kosto administrative | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | MSHMS/ OSHC | | | | | | | | | | |
| | 96601AA (MSHMS) | | | | | | | | | | |
| 2.1.3 | **Krijimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mekanizmave të bashkëpunimit dhe komunikimit të Rrjetit me publikun dhe median** | | **Kosto administrative** | | | Kosto administrative | **100%** | **I ZBATUAR** | | | 6M I 2020 |
| 2.1.3.a | Caktimi i personit përgjegjës për komunikimin e Rrjetit me median dhe publikun (I) Komunikim\i dhe ndërveprimi midis institucioneve publike dhe qytetarëve dhe medias në kuadër të ELP-së, i përmirësuar dhe i lehtësuar (II) | | Kosto administrative | | | Kosto administrative | **100%** | **I ZBATUAR (KSH)**<br>Kuvendi ka caktuar një person përgjegjës, nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun, për komunikimin e Rrjetit me median dhe publikun. | | | |
| | Kuvendi | | | | | | | | | | |
| 2.2 | **Objektivi Specifik 2.2: Zhvillimi i mekanizmave të bashkëpunimit e komunikimit me publikun e median** | | | | | | **50%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| 2.2.1 | **Plani i Komunikimit të Rrjetit me publikun dhe median ("Plani i Komunikimit") i hartuar** | | **Kosto administrative** | | | | **50%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | 6M II 2020 |
| 2.2.1.a | Hartimi, konsultimi dhe miratimi i Planit të Komunikimit të Rrjetit (I) Plani i Komunikimit të Rrjetit i rishikuar (në vijimësi për çdo vit zbatimit të PV) | | **Kosto administrative** | | | Kosto administrative | **100%** | **I ZBATUAR (KSH)**<br>Për vitin 2020 Kuvendi ka zhvilluar 1 takim të Rrjetit, 2 mbledhje të Komisionit Drejtues dhe një mbledhje të Bordit Këshillimor | | | |
| | Kuvendi/ Autoritete Publike (anëtare të Rrjetit) | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 90202AA | | | | | | | | | | | 6M II 2020 |
| 2.2.1. b | Marrëveshje bashkëpunimi me NJQV-të për të vendosur standardin e bashkëpunimit dhe ndërveprimit reciprok në planifikimin e aktiviteteve | | **Kosto administrative** | | | | **0% Pa raportuar** | **PA ZBATUAR/PA RAPORTUAR (MB)** | | | |
| | MB/AMVV (NJQV) | | | | | | | | | | | |
| | 91602AC | | | | | | | | | | | 6M II 2020 |
| 2.3 | **Objektivi Specifik 2.3: Konkretizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet realizimit të iniciativave të përbashkëta të ELP-së** | | | | | **66.7%** **246 lekë Don. +** **8,250 lekë B.Sh** | **88.3%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | |
| 2.3.1 | **Iniciativat e përbashkëta ndërinstitucionale të ELP-së të zhvilluara dhe përditësuara (të paktën 3 iniciativa/vit)** | | **7,055** **Financ.Huaj** | 2000 EU | | 100% 246 lekë Donatorë | **87.5%** | **I ZBATUAR** | | | |
| 2.3.1. a | Edukimi ligjor i grupeve të interesit për heqjen e qeses plastike nga përdorimi | | 1,055 Financ.Huaj | Kosto Administrative | | | **100%** | **I ZBATUAR (MTM)** Takime me grupin e ricikluesve dhe grupimin e bisneseve që kanë si bisnes marketet. | Situata Covid-19 ka bërë të mundur vetëm takime online | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | MTM/ OSHC | | | | | | | | | | 6M II 2020 |
| 2.3.1. b | Edukimi ligjor i grupeve të interesit mbi kuadrin ligjor të përditësuar për barazinë gjinore/DHBGJ dhe dhuna në familje në kuadër të fushatës "16 ditët e aktivizimit të DHBGJ"<br>*Aktiviteti kryhet çdo vit në periudhën 25 nëntor–10 dhjetor | | 4,000<br>Financ.Huaj | | Donator/UNFPA | 100 % për vitin 2020 | **100%** | **I ZBATUAR (MSHMS)** | | | |
| | MSHMS/OSHC | | | | | | | | | | 6M I 2020 |
| 2.3.1. c | Edukimi ligjor i qytetarëve dhe grupeve në nevoje mbi ligjin për ndihmën juridike falas, shërbimet sociale të ofruara nga Bashkitë dhe procedurat e ankimit (fletëpalosje, broshura, edukim ligjor në 12 njësi administrative, intervista televizive, forume). | | 2,000<br>Worldvision/BE | 2000EU | 100 % (QA) | 50% (QA) | **Realizuar në masën 100%**<br><br>**50% (QA)** | **I ZBATUAR (DNJF)**<br><br>Duke qenë tërësisht të vetëdijshëm se rritja e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj përveçse një detyrimi ligjor (neni 8 i ligjit 111/2017), është një nga komponentët me thelbësorë të funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dhe forcimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi, DNJF i ka kushtuar një vemëndje të shtuar informimit mbi sistemin e ndihmës juridike falas duke u ndalur në hartimin dhe publikimin e materialeve të vizibilititetit si dhe publikimit të postimeve/videove ndërgjegjësuese në rrjetet sociale të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.<br>***1. Zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të forcimit të sistemit të ndihmës juridike parësore.***<br><br>***Aktivitet Ndërgjegjësues "Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin", Kavajë, 09 Mars 2020***<br>Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve është një nga parimet më thelemore të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Formë e mbrojtjes së këtij interesi është edhe aksesi në drejtësi për të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin duke garantuar një shërbim ligjor falas dhe cilësor. Nga ky | *Problematikë ka rezultuar gjëndja e pandemisë dhe vështirësitë e krijuara si pasojë e masave kufizuese e të ndërmarra.* | | Është një msë e cila vijon duke qënë se është edhe detyrë funksionale e DNJF. |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | këndvështrim, ishte e nevojshme të bëheshin ndryshime ligjore në legjislacionin e procedurës penale dhe gjithashtu në ligjin "Për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti".<br>Pjesë e këtyre aktiviteteve ishte dhe Aktivtiteti "A*ksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin*" i cili u zhvillua me qëllim ndërgjegjësimin e të miturve pranë Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve Kavajë. Ky aktivitet u zhvillua në 3 seksione ku përfaqësuesit e ndihmës juridike falas patën mundësinë të bashkëbisedonin me të miturit e kësaj qendre duke i shpjeguar në mënyrë të thjeshtëzuar se si ata apo prindërit e tyre mund të përfitonin nga shërbimet ligjore falas.<br>Të miturit gjatë takimit informues u shfaqën mjaft të interesuar për t'u informuar mbi mënyrën e përfitimit të këtij shërbimi. Shumica prej tyre i shprehën problematikat ligjore më të cilat përballen familjarët e tyre të cilat lidheshin më së tepërmi me "detyrimin për ushqim" si dhe me kërkesat për "revokimin e avokatëve të caktuar kryesisht".<br>Me qëllim zgjidhjen e këtyre problematikave dhe përfitimin e shërbimit nga këta të mitur, përfaqësuesit e DNJF shkëmbyen kontaktet me Punonjësit Socialë të Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve Kavajë të cilët ishin mëse të gatshëm për bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas në trajtimin e këtyre rasteve.<br><br>***Tryezë e Përbashkët në kuadër të promovimit dhe nxitjes së sistemit të ndihmës juridike falas, Elbasan 05 Mars 2020***<br>Më datë 5 Mars DNJF me zhvilloi një tryezë të përbashkët me përfaqësues nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan, Bashkia Elbasan, Drejtoria e Policisë Vendore dhe përfaqesues të Organizatave Jofitimprurëse. Qellimi i kesaj tryeze konsistonte në rendesine dhe efikasitetin që duhet te ketë Sistemi i Ndihmës Juridike Paresore dhe fokusin për te rritur urat e bashkëpunimit nderinstitucional në mënyrë të tillë që çdo qytetari t'i garantohet akses në Drejteësi. Tryeza rezultoi mjaft frytdhënëse në kuadër të lidhjes së urave të bashkëpunimit me aktorët ndër institucionalë. | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | ***Intervista televizive me qëllim përcjelljen e njohurive mbi sistemin e ndihmës juridike falas tek qytetarët***<br>Më datë **17 qershor 2020**[25], 2 specialistë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas janë ftuar në emisionin "Mirmëngjes Shqipëri" në Radio Televizionin Shqiptar gjatë të cilit është diskutuar mbi ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas gjatë periudhës së pandemisë, sistemin e ndihmës juridike falas, ofruesit e këtij shërbimi dhe kategoritë përfituese.<br>Në **muajin Nëntor të vitit 2020** është realizuar intervista televizive me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec dhe kryetarit të Dhomës Vendore të Avokatisë Korçë në të cilën është folur mbi sistemin e ri të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, kushtet e përfitimit, ofruesit e shërbimit dhe informacione të tjera të nevojshme për informimin ligjor të publikut.<br>Këto intervista kanë vijuar të zhvillohen përgjatë muajit dhjetor me qëllim përmbushjen e objektivit të DNJF lidhur me promovimin e sistemit të ndihmës juridike falas dhe edukimin ligjor të publikut.<br><br>***Publikime dhe produkte të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të vizibilitetit.***<br>***Publikimi i manualit "Si të përfitojmë ndihmë juridike falas"***<br>DNJF në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 8 shkronja "d" dhe "e" të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", ka vijuar me hartimin dhe publikimin e një manuali të thjeshtëzuar mbi kriteret dhe procedurën e përfitimit nga shërbimet e ndihmës juridike falas. Manuali për ndihmën juridike u është përcjellë disa | | | |

[25] Linku i intervistës: https://youtu.be/tv-4ëtNcODg

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | institucioneve si Bashkia Tiranë, Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Kryeministrisë në kuadër të nxitjes dhe bashkëpunimit.<br><br>- *Promovimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore përmes vendosjes së posterave pranë institucioneve kryesore në vend.*<br>DNJF në kuadër të përmbushjes së këtij aktiviteti, ka zhvilluar një sërë takimesh me EURALIUS V19 sa i përket përmbajtjes së posterave. Në muajin Shtator 2020 u bë i mundur dizejnimi dhe printimi i mbi 500 posterave adezivë promovues të sistemit të ndihmës juridike falas me qëllim afishimin e tyre pranë institucioneve shtetërorë në gjithë Republikën e Shqipërisë.<br>Gjithashtu, janë hartuar dhe vendosur në dispozicion të qytetarëve fletëpalosje të dedikuara për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat DNJF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.<br><br>***Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare[26] në kuadër të transparencës dhe informimit të qytetarëve.***<br>Që prej muajit Mars 2020, është finalizuar faqja zyrtare e DNJF dhe është vendosur në dispozicion të publikut. Aktualisht DNJF është duke e përditësuar faqen në mënyrë aktive përmes publikimit të raportimeve të ndryshme në kuadër të transparencës si dhe manualeve në ndihmë të qytetarëve për përfitimin e shërbimit.<br><br>***Promovimi i sistemit të shërbimit të ndihmës juridike falas përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram.***<br>Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët dhe duke marrë parasysh faktin se ky shërbim është relativisht i ri dhe i panjohur për të shumtën e qytetarëve, DNJF është duke punuar në mënyrë të vazhdueshme për promovimin e këtij sistemi | | | |

[26] https://ndihmajuridike.gov.al/

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram të cilat janë mjaft të përdorshme nga qytetarët. Kemi vijuar me postime të vazhdueshme informative mbi procedurat që duhen ndjekur për përfitimin e këtij shërbimi si dhe janë mbajtur komunikime të vazhdueshme me qytetarët të cilët na janë drejtuar për të kërkuar informacion.<br><br>***Përfshirja e sistemit të ndihmës juridike falas si E-shërbim në platformën E-albania.***<br>Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët, promovimi dhe informimi mbi këtë sistem është një element kyç në kuadër të rritjes së aksesit të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë. Si një mjet mjaft i mirë në kuadër të përmbushjes së këtij qëllimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas me shkresën me nr. 371 prot., datë 23.09.2020 i ka propozuar Ministrië së Drejtësisë dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, përfshirjen e ndihmës juridike falas si E-shërbim në Platformën E-ALBANIA. Kjo platformë, sidomos periudhën aktuale për shkak të pandemisë Covid-19, ka një përdorim mjaft të gjerë ndaj edhe përfshirja e E-shërbimit “Ndihmë juridike falas” do të ketë një impakt në rritjen e nivelit të informacionit të qytetarëve mbi këtë sistem. Që prej datës 17 Dhjetor 2020, Të gjithë shtetasit tashmë mund të përfitojnë shërbimet e këshillimit ligjor direkt nga *e-albania* bashkë me të gjitha shërbimet e tjera online[27].<br><br>***Platforma e katërt Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri.***<br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mori pjesë në Platformën e katërt Kombëtare për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri e cila u mbajt online në datë 29 Shtator 2020, organizuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal Ekipi i Veprimit për Integrimin e Romëve, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. | | | |

[27] https://e-albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=787&service_type=N

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Në këtë takim, u prezantua “Raporti mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri, për vitin 2019” dhe u diskutuan politikat kombëtare dhe prioritetet për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në fushat kryesore, pjesë e së cilave ishin edhe masat dhe indikatorët të cilat janë nën fushën e përgjegjësisë së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.<br><br>***Takim me Shoqatën “Unë, Gruaja” Nëntor 2020.***<br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, si një nga aktorët mbështetës për projektin “Ligji është jetë – Mbrojeni jetën tuaj!” mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Shoqata Shoqata Une, Gruaja për Vullnetarët e Ligjit me temë: “Rritja e kapaciteteve për grupet mbështetëse në lidhje me informacionin ligjor për publikun dhe qasjen e tij në drejtësi”.<br>Ky trajnim u organizua në kuadër të projektit: “Ligji është jetë- Mbrojeni jetën tuaj!” i cili po zbatohet nga Shoqata “Unë, Gruaja” në Korçë dhe Pogradec me mbështetjen UNDP Albania dhe fonde të Agjencisë Austriake për Zhvillim.<br>Projekti “Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri” zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministria e Drejtësisë dhe financim të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA)”<br><br>***Afishimi i posterit “Ke nevojë për ndihmë juridike”, në ambientet e pushtetit qendror, lokal dhe sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, Dhjetor 2020.***<br>Në përmbushje të misionit madhor të Ministrisë së Drejtësisë, garantimit të aksesit në drejtësi për çdo qytetar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e qeverisjes e nivelit qëndror, lokal dhe sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.<br>Në këtë kuadër, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka vijuar me komunikimet me qëllim promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit tek qytetarët në lidhje me sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti duke kërkuar nga institucionet shtetërore | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | afishimin e posterave “Ke nevojë për ndihmë juridike”.<br>Këto postera janë konceptuar nga Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Euralius V, ku platforma jurstionline.al dhe numri i gjelbër 0801010 janë financuar nga “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” dhe kanë për qëllim kryesor ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe orientimin e tyre drejt sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, si element thelbësor i aksesit në drejtësi.<br><br>***Nënshkrimi i 25 marrëveshjeve “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” me Gjykatat e Republikës së Shqipërisë, Dhjetor 2020.***<br>Në përmbushje të misionit madhor të Ministrisë së Drejtësisë, “Sigurimit të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive, për të gjithë kategoritë përfituese”, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka nënshkruar 25 marrëveshje me Gjykatat e Republikës së Shqipërisë me objekt :“Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.<br>Duke vlerësuar maksimalisht rolin që kanë Gjykatat në sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, këto marrëveshje janë një vlerë e shtuar në përmbushje të misionit të DNJF.<br>**2. Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit**<br><br>***Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Fierit, Nëntor 2020.***<br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas po vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si edhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas.<br>Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF ishte në qytetin e Fierit ku organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u afishuan postera të | | | |

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | ndihmës juridike në institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; Prokuroria; Bashkia; Shtëpia e të moshuarve; ADISA... etj si dhe u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.<br><br>***Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Lezhës, Nëntor 2020***.<br>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas po vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si edhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas.<br>Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF ishte në qytetin e Lezhës ku organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u afishuan postera të ndihmës juridike në institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Prokuroria; Bashkia; etj si dhe u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.<br><br>***Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Tiranës, Nëntor 2020.***<br>Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.<br><br>***Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Durrësit, Dhjetor 2020.***<br>Gjatë muajit dhjetor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.<br><br>***Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Shkodrës, Dhjetor 2020.***<br>Gjatë muajit dhjetor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.<br><br>***Takim informues me qytetarë të komunitetit Romë dhe Egjiptian në Shkozë, Tiranë mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Nëntor 2020.***<br>Ekipi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas organizoi një takim me qytetarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian në zonën e Shkozës, Tiranë, bashkë me përfaqësuesit e **Klinikës Ligjore Wisdom**, me të cilët është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi.<br>Pjesëmarrësit, si një ndër kategoritë përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, u informuan mbi të drejtat që ligji për ndihmën juridike u garanton dhe mënyrën e përfitimit të ndihmës juridike falas.<br>U zhvillua një bashkëbisedim mbi problematikat ligjore të qytetarëve, të cilat do të adresohen për t'u trajtuar në Klinikën e Ligjit Wisdom dhe Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë.<br>**EUROPEAN CENTRE**<br><br>Ofrimi i ndihmes juridike paresore dhe dytesore nga Klinika e Ligjit – Vlore; - Sesione informuese mbi sherbimet e Klinikes se Ligjit dhe ofrimit te ndihmes juridike falas; - Shperndarja e nje fletepalosje informuese.<br><br>**ZBATUAR PJESËRISHT/ NË PROCESS (QA)**<br><br>Fletë informuese mbi ndihmën ekonomike, respektimin e të drejtave të përsonave me aftësi të kufizuar dhe fletëinformuese për ndihmën juridike parësore; Ofrimi i ndihmës juridike parësore | | | |
| | DNJF/IAL Shkodër, NJQV Kukës, Lezhë, Kurbin/OSHC | | | | | | | | | | |
| 2.3.2 | **Instrumentet për veprimtaritë dhe bashkëpunimin në fushën e ndihmës juridike falas në nivel qendror dhe nivel vendor, të përmirësuara** | | 115 | | | | **100%** | **I ZBATUAR** | | | 6M I 2020 |
| 2.3.2. a | Hartimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me OSHC-të, klinikave të ligjit për ofrimin | | 115 | | | **0** | **Realizuar në masën 100%** | **I ZBATUAR**<br><br>**Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.** | | | Lidhja e marrëvesh |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | e ndihmës juridike falas (kontrata bashkëpunimi) | | | | | | | *Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, "Klinikë ligjore" është njësia përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.*<br><br>Në total për vitin 2020, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur **9 (nëntë) Marrëveshje Bashkëpunimi**, të dhëna specifike mbi të cilat janë parashtruar si vijon:<br><br>Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin e Drejtësisë- 20 Shkurt 2020;<br><br>Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Bedër - 13 Maj 2020;<br><br>Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Wisdom - 20 Maj 2020;<br><br>Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Europian të Tiranës - 4 Qershor 2020;<br><br>Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës - 16 Qershor 2020;<br><br>Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Ismail Qemali Vlorë - 13 Qershor 2020;<br><br>Marrëveshje Bashkëpunimi me Kolegjin Universitar Qiriazi - 30 Shtator 2020;<br><br>Marreveshje Bashkëpunimi me Universitetin Mesdhetar - 24 Nëntor 2020;<br><br>Marrëveshje Bashkëpunimi me Fondacionin OSFA (Klinika e Ligjit Shkodër) - 3 Nëntor 2020.<br>Në funksion të shtrirjes së këtij bashkëpunimi, më datë 28.10.2020, u zhvillua takimi i parë teknik me | | | jeve të reja vijon dhe DNJF është shprehur e gatshme për bashkëpunime dhe aktvitete të reja. |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me të cilat Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë këtij takimi u diskutua për rolin që u është atribuar me ligj Klinikave të Ligjit, si ofrues të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike falas dhe masat që duhen ndërmarrë me qëllim vendosjen e tyre në të njëjtën linjë me Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara. Pavarësisht se ndodhemi në kushtet e një viti të ri akademik sfidues, referuar masave kufizuese të ndërmarra për shkak të pandemisë, nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe përfaqësuesve të Klinikave u shpreh angazhimi maksimal dhe gadishmëria për bashkepunim të mëtejshëm.<br>Të gjitha këto Klinika po vijojnë bashkëpunimin me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas qoftë sa i përket raportimit të të dhënave, qoftë sa i përket pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta, përmendim këtu aktivitetin e datës 3 Dhjetor 2020, në bashkëpunim me Klinikën e Ligjit pranë Kolegjit Universitar Wisdom dhe shoqatën “Rreze Drite” me qytetarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian në zonën e Shkozës[28].<br>Gjithashtu, në kuadër të përditësimit të njohurive praktike të studentëve të angazhuar pranë këtyre Klinikave është hapur thirrja për studentët e interesuar që janë duke ndjekur studimet në drejtësi pranë Fakulteteve të Drejtësisë që të angazhohen pranë Klinikave të Ligjit me qëllim përfitimin e njohurive praktike pranë këtyre Klinikave si dhe angazhimin e tyre në kuadër të:<br><br>Pjesëmarrjes në webinare/trajnime të zhvilluara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mbi ligjin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;<br><br>Pjesëmarrje në aktivitete sensibilizuese/edukimin ligjor që publikut të planifikuara për t’u zhvilluar | | | |

[28] Pjesëmarrësit, si një ndër kategoritë përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, u informuan mbi të drejtat që ligji për ndihmën juridike u garanton dhe mënyrën e përfitimit të ndihmës juridike falas.

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas përgjatë vitit 2021;<br><br>Zhvillimit të praktikave 3 mujore të punës pranë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore që Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas administron;<br><br>Zhvillimit të praktikave të punës pranë Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë që përfitojnë financim nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike parësore. | | | |
| | DNJF/ IAL (klinika ligji) | | | | | | | | | | |
| | Kodi i produktit DNJF 91406AA;18AR501 | | | | | | | | | | 6M I 2020 |
| 2.3.4 | **Iniciativat e përbashkëta midis OSHC-ve/klinikave të ligjit dhe organit që administron ndihmën juridike falas/DNJF të zhvilluara** | | **1,673** | 8,250 lekë | 34,3 % | **34.3%**<br><br>8,250 lekë | **80%** | **I ZBATUAR PJESËRISHT** | | | 6M I 2020 |
| 2.3.4. a | Fushata sensibilizimi mbi ligjin për ndihmën juridike falas (fletëpalosje/takime/aktivitete përbashkëta institucionale):<br>Mars 2020: zhvillimi i një fushate ndërgjegjësuese me aktorët e shoqërisë civile/institucionet publike në qytetin e Elbasanit<br>(aktivitete në vijimësi gjatë kohës së zbatimit të këtij PV) | | 966 | 8,250 lekë<br><br>(24.000 EU) | 34,3 % | **34.3%**<br><br>(100% e buxhetit te planifikuar per 2020) | **Realizuar në masën 100%** | **I ZBATUAR (DNJF)**<br><br>**Në funksion të përmbushjes së kësaj mase të parashikuar, DNJF ka zhvilluar disa aktivitete të përbashkëta me OSHC-të, OJF-të e autorizuara për të ofruar ndihmën juridike parësore si dhe Klinikat e Ligjit me të cilat kemi lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi, konkretiosht:**<br><br>***Takim me organizatat jofitimprurëse të autorizuara që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti.***<br>Më datë 10.09.2020, u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së autorizimeve nga ana e Ministrit të Drejtësisë të 12 organizatave jofitimprurëse të autorizuara me një shtrirje gjeografike në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër dhe Berat. Gjatë këtij takimi u vu theksi në prioritetin që i jepet ndihmës juridike falas, në realizimin e së cilit kanë qenë mbështetës aktorët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile. Organizatat jofitimpruëse krahas Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Klinikave të Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, përmes | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | eksperiencës së tyre shumëvjeçare do të sigurojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas tek qytetarët në mënyrë profesionale dhe cilësore, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.<br><br>***Publikime dhe produkte të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të vizibilitetit.***<br>***Publikimi i manualit "Si të përfitojmë ndihmë juridike falas"***<br>DNJF në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 8 shkronja "d" dhe "e" të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", ka vijuar me hartimin dhe publikimin e një manuali të thjeshtëzuar mbi kriteret dhe procedurën e përfitimit nga shërbimet e ndihmës juridike falas. Manuali për ndihmën juridike u është përcjellë disa institucioneve si Bashkia Tiranë, Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Kryeministrisë në kuadër të nxitjes dhe bashkëpunimit.<br><br>***Promovimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore përmes vendosjes së posterave pranë institucioneve kryesore në vend.***<br>DNJF në kuadër të përmbushjes së këtij aktiviteti, ka zhvilluar një sërë takimesh me EURALIUS V19 sa i përket përmbajtjes së posterave. Në muajin Shtator 2020 u bë i mundur dizejnimi dhe printimi i mbi 500 posterave adezivë promovues të sistemit të ndihmës juridike falas me qëllim afishimin e tyre pranë institucioneve shtetërorë në gjithë Republikën e Shqipërisë.<br>Gjithashtu, janë hartuar dhe vendosur në dispozicion të qytetarëve fletëpalosje të dedikuara për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas dhe Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat DNJF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.<br><br>***Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare[29] në kuadër të transparencës dhe informimit të qytetarëve.***<br>Që prej muajit Mars 2020, është finalizuar faqja zyrtare e DNJF dhe është vendosur në dispozicion të publikut. Aktualisht DNJF është duke e përditësuar faqen në mënyrë aktive përmes publikimit të raportimeve të ndryshme në kuadër të transparencës si dhe manualeve në ndihmë të qytetarëve për përfitimin e shërbimit. | | | |

[29] https://ndihmajuridike.gov.al/

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
